



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 000, Datë 00.00.2000

“Titulli Lorem ipsum dolor sit amet, consectetur adipiscing elit, sed do eiusmod tempor incididunt ut labore et dolore magna aliqua”

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe

VENDOSI:

1. Lorem ipsum dolor sit amet, consectetur adipiscing elit, sed do eiusmod tempor incididunt ut labore et dolore magna aliqua.
2. Morbi dignissim risus turpis. Sed interdum condimentum. Vestibulum porta purus vel nisi. Sed eu dictum ante. Donec auctor ornare odio.
3. Morbi dignissim risus turpis. Sed interdum condimentum. Vestibulum porta purus vel nisi. Sed eu dictum ante. Donec auctor ornare odio.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS



AUTORITETI I
KONKURRENCËS

PËRMBAJTJA

Nr. 854, Datë 14.01.2022.....	1
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FABRIKA DECJE HRANE D.O.O NGA SHOQËRIA NELT CO D.O.O”	
Nr. 855, Datë 14.01.2022.....	3
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NGA PËRFTIMI I KONTROLLIT NËPËRMJET BLERJES SË 80.27% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË ALBTELECOM SHA NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”	
Nr. 856, Datë 21.01.2022.....	7
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES STAR PARKING ALBANIA SHPK NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT)”	
Nr. 857, Datë 21.01.2022.....	13
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ELMTRONICS GROUP LIMITED NGA SHOQËRIA MER UK HOLDING LIMITED”	
Nr. 858, Datë 21.01.2022.....	17
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË VOITH HYDRO HOLDING VERWALTUNGS GMBH NGA SHOQËRITË E GRUPIT VOITH”	
Nr. 859, Datë 21.01.2022.....	21
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTËR SHA”	
Nr. 860, Datë 31.01.2022.....	25
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË DISA ASETIVE TË SHOQËRISË AUTOMOBIL-LOGISTIK-MOSOLF GMBH NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN GROUP SERVICES GMBH”	
Nr. 861, Datë 31.01.2022.....	29
“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË THELLUAR PËR VLERËSIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA TELECOM INVEST AD NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”	

Nr. 862, Datë 31.01.2022.....	33
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJES VODAFONE ALBANIA SHA NË TREGUN E SHËRBIMEVE CELULARE: TREGU ME SHUMICË I TERMINIMIT TË THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE”	
Nr. 863, Datë 15.02.2022.....	37
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”	
Nr. 864, Datë 15.02.2022.....	41
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTË, NGA SHOQËRITË DAIMLER TRUCK AG, TRATON INTERNATIONAL S.A DHE VOLVO ENERGY AB”	
Nr. 865, Datë 25.02.2022.....	45
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ELPRO GROUP AG NGA SHOQËRIA ROBERT BOSCH INTERNATIONALE BETEILIGUNGEN AG”	
Nr. 866, Datë 25.02.2022.....	47
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë”	
Nr. 867, Datë 04.03.2022.....	49
“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR “MBI VEPRIMTARINË E AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2021 DHE PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2022””	
Nr. 868, Datë 04.03.2022.....	51
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SCAN SHA NGA SHOQËRIA BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”	
Nr. 869, Datë 08.03.2022.....	55
“MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA TELECOM INVEST AD NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”	
Nr. 870, Datë 18.03.2022.....	71
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM - 934 SHPK, FERRA&CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”	

Nr. 871, Datë 25.03.2022.....	75
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALPHA BANK ALBANIA SHA NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT”	
Nr. 872, Datë 25.03.2022.....	79
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT NGA SIEMENS ENERGY AG, NËPËRMJET FILIALIT TË ZOTËRUAR PLOTËSISHT, SIEMENS GAS AND POWER HOLDING B.V., MBI BIZNESIN GREK TË ENERGJISË”	
Nr. 873, Datë 25.03.2022.....	83
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË A4NXT GMBH DHE LUFTHANSA INDUSTRY SOLUTIONS AS GMBH”	
Nr. 874, Datë 25.03.2022.....	87

VENDIM

Nr. 854, Datë 14.01.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FABRIKA DECJE HRANE D.O.O NGA SHOQËRIA NELT CO D.O.O”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fabrika decje hrane d.o.o nga shoqëria Nelt CO d.o.o.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fabrika decje hrane d.o.o nga shoqëria Nelt CO d.o.o.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Fabrika decje hrane d.o.o nga shoqëria Nelt CO d.o.o.

Referuar [.....] të nënshkruar më datë [.....], palët janë:

Blerësi: Nelt CO d.o.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Serbisë, me objekt aktiviteti: shitjen me shumicë të sheqerit, çokollatave dhe ëmbëlsirave. Shoqëria Nelt CO d.o.o është pjesë e Grupit Nelt.

Grupi Nelt është kryesisht aktiv në shpërndarjen e mallrave të konsumit, distribuimit të produkteve farmaceutike, ndërmjetësim doganor dhe logjistikë, si dhe është aktiv në industrinë e mishit.

Grupi Nelt ka një filial në Shqipëri, shoqërinë Nelt SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import-eksporti dhe tregtimi me shumicë dhe me pakicë i të gjithë artikujve industrialë, të konsumit të gjerë, ushqimore, kinkalerie, tregtim i produkteve kozmetike, farmaceutike dhe i karburanteve të ndryshme etj.

Nelt SHPK është në pronësi të plotë të Neregelia Trading Limited, një shoqëri qipriote, shoqëria mëmë e Grupit Nelt.

Shitësi: Charnesco Services Limited, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qipro. I gjithë kapitali i Fabrikës së Ushqimit për Fëmijë është në pronësi të Charnesco Services Limited.

Target: Fabrika decje hrane d.o.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Serbisë, me objekt aktiviteti: prodhimin e ushqimit për fëmijë (ushqim për foshnjat dhe fëmijët deri në 3 vjeç), si poretë e mishit, frutave dhe perimeve, drithërat e thata etj, por gjithashtu prodhon edhe ushqime konvencionale për të rritur (lëngje dhe pure).

Fabrika decje hrane d.o.o [.....].

Më datë [.....], shoqëritë [.....].

[.....] në bazë të së cilës do të implementohet transaksioni.

Përfundimi i përqendrimit do të ndodhë [.....].

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të ushqimeve për fëmijë 0-3 vjeç, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Fabrika decje hrane d.o.o, nga shoqëria Nelt CO d.o.o, [.....].

Shoqëria Nelt CO d.o.o., i përket dhe operon brenga grupit të shoqërive Nelt. Shoqëria mëmë e grupit Nelt është shoqëria Neregelia Trading Limited, e cila realizon të ardhura dhe është prezente në Shqipëri nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej saj Nelt SHPK. Nëpërmjet këtij transaksioni, [.....].

Fabrika decje hrane d.o.o [.....].

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të të shoqërisë Fabrika decje hrane d.o.o nga shoqëria Nelt CO d.o.o Beograd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 855, Datë 14.01.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NGA PËRFTIMI I KONTROLLIT NËPËRMJET BLERJES SË 80.27% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË ALBTELECOM SHA NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nga përftimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitje dhe blerje aksionesh”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

Shoqëria zotërohet nga [.....]

4iG Nyrt nuk ka asnjë aktivitet dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: Cetel Telekom İletişim Sanayi Ve Ticaret Anonim Şirketi (Cetel), është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, e cila zotërohet nga Çalık Holding A.S. dhe shoqëria Türk Telekomünikasyon.

Shoqëria Cetel është zotëruese e 80,274% të aksioneve të shoqërisë target, Albtelecom SHA.

Garantuesi i Shitësit: Çalik Holding Anonim Sirketi është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë, me objekt aktiviteti: Menaxhimin e Kompanive dhe Industrisë së Ndërmarrjeve.

Shoqëria garantuese është aksionari i vetëm i shoqërisë Banka Kombëtare Tregtarë SHA dhe është pjesë e marrëveshjes së njoftuar si garantues i Shitësit për kontratat/marrëveshjet e parashikuara në marrëveshjen e shitjes dhe blerjes së aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA.

Shoqëria Target: Albtelecom SHA, është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Shërbimet e komunikimeve elektronike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për komunikimet elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me përcaktimet e licensave që jepen për shoqërinë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ku përfshihen por pa u kufizuar, shërbime të tilla si: shërbimi publik i telefonisë tokësore të lëvizshme, transmetimi i të dhënave, etj.

Shoqëria Albtelecom SHA zotërohet nga shoqëria Cetel Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret A.S. me 80,274% të aksioneve; Posta Shqiptare SHA me 2,466% të aksioneve; Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me 16.77 % të aksioneve dhe aksionarë të tjerë (persona fizikë) 3,478 % të aksioneve.

Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Cetel Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret AS (shitësi), shoqërisë 4iG Nyrt (blerësi) dhe Çalik Holding Anonim Sirketi (Garantuesi i Shitësit), është lidhur “Marrëveshje shitje dhe blerje aksionesh”, datë 08 dhjetor 2021.

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi ka rënë dakord të shesë dhe blerësi ka rënë dakord të blejë Aksionet për Konsideratë dhe në varësi të kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Blerësi do të marrë përsipër borxhin sipas Kredisë Totale të Aksionareve dhe Garantuesi i Shitësit ka rënë dakord të kontribuojë një pjesë të huasë së aksionarëve në kapitalin e blerësit, në këmbim të aksioneve të shitjes 4iG, sipas kushteve të përfshira në këtë Marrëveshje, Marrëveshjen e Kontributit dhe në Marrëveshjen e Transferimit të Borxhit.

Në përfundim të transaksionit shoqëria 4iG Nyrt do të zotërojë 80.27% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, Albtelecom SHA.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje, shoqëria 4iG Nyrt synon të fitojë akses në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, në zhvillimin e shërbimeve të pashërbyer B2B, B2C dhe B2G të telekomunikacionit fiks dhe celular, televizionit si dhe të shërbimeve të IT në Shqipëri.

Mbyllja e Marrëveshjes do të kushtëzohet nga plotësimi i kushteve; marrjen e pëlqimit nga BKT për Transaksionin, marrjen e konfirmimit nga Autoriteti i Konkurrencës, AKEP, AMA, marrjen e pëlqimit nga çdo palë kontraktuale për një ndryshim të dispozitës së kontrollit, etj.

Në lidhje me këto detyrime, Autoriteti ka administruar vendimin nr.1, datë 07.01.2022 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, nëpërmjet të cilit është vendosur pranimin e kërkesës së shoqërisë Albtelecom SHA mbi ndryshimet në strukturën e pronësisë së saj, për kalimin e aksioneve të Cetel Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi (aksionar me 80.27 % të aksioneve”, tek aksionari 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, nëpërmjet vendimin nr. 1, datë 10.01.2022 mbi “Njoftimin zyrtar të sipërmarrësit Albtelecom SHA, për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare”, sqaron se nenet 71 dhe 74 të ligjit nr.9918/2008, i ndryshuar, e lidhin ngushtë detyrimin e çdo sipërmarrësi të pajisur me Autorizim Individual për të kërkuar dhënien e miratimit paraprak nga AKEP, me të

drejtën e tyre për të kërkuar transferimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave për qëllime civile nga një sipërmarrës tek një tjetër.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar, konstatohet se Marrëveshja e njoftuar, shkakton një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Albtelecom SHA, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i komunikimeve elektronike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i komunikimeve elektronike është një treg, i cili mbikqyret dhe rregullohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Mbështetur në analizat e tregut të komunikimeve elektronike, AKEP ka vlerësuar se në këtë treg përfshihen; - nën tregjet e rrjedhës së sipërme (shumicë) dhe - nën tregjet e pakicës si në shërbimin e telefonisë së lëvizshme ashtu edhe në shërbimin e telefonisë fikse.

Referuar statistikave të AKEP, mbi të ardhurat e realizuara nga komunikimet elektronike për vitin 2020, evidentohet se operatori me peshën më të madhe të të ardhurave në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike (fikse dhe celulare), është Vodafone Albania me rreth 38% të totalit të të ardhurave; i ndjekur nga One Telecommunications me rreth 24%; Albtelecom me rreth 21% të tregut dhe pjesa tjetër rreth 17% të tyre.

Në shërbimin e terminimit të thirrjeve, rrjedha e sipërme (*upstream*), çdo operator celular apo fiks zotëron 100% të rrjetit të tij individual pasi nuk ka zëvendësues për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet individual. Në këtë kontekst, Albtelecom ka 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij të telefonisë celulare si dhe 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij fiks.

Transaksioni i propozuar, nuk ngre shqetësim për konkurrencën në lidhje me tregun me shumicë për shërbimet e terminimit të thirrjeve dhe pozicioni i Albtelecom SHA do të mbetet i njëjtë në tregun e terminimit të thirrjeve me shumicë.

Në tregun e shërbimeve me pakicë, është vlerësuar se tregu i telefonisë së lëvizshme dhe tregu i telefonisë fikse janë të pazëvendësueshëm me njëri tjetrin dhe si të tillë dy tregjet, në nivelin e pakicës, janë analizuar të veçuar.

Tregu i telefonisë celulare është një treg me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të certifikatave të përdorimit të brezit të frekuencave dhe në këtë treg operojnë 3 ndërmarrje. Vodafone Albania SHA është ofruesi më i madh i shërbimeve celulare, i ndjekur nga One Communications SHA. Shoqëria Albtelecom SHA renditet e treta duke zotëruar 13-16% pjesë të tregut për të gjithë treguesit e përdoruesve aktivë, pajtimtarë të kartave SIM, thirrje dalëse, SMS, trafik interneti, përdorues aktivë të broadband; 13% të tregut për të ardhurat totale dhe 14% të ardhurat nga shërbimet me pakicë.

Nga analiza e tregut të shërbimit të telefonisë celulare me pakicë dhe vlerësimit të marrëveshjes mes shoqërive 4iG Nyrt dhe Albtelecom SHA, konstatohet se vetëm Albtelecom SHA operon në tregun përkatës të produktit dhe transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje të pjesëve të tregut mes 4iG Nyrt dhe Albtelecom SHA dhe për rrjedhojë nuk do të këtë krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë Albtelecom SHA në tregun e shërbimit të telefonisë celulare me pakicë.

Sipas të dhënave statistikore të AKEP, rezulton se numri i operatorëve të autorizuar **në tregun e shërbimit të telefonisë fikse**, që kanë raportuar se kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2020, është rreth 40 dhe 183 operatorë kanë ofruar shërbimet broadband fiks.

Shoqëria Albtelecom SHA është ofruesi më i madh i këtij shërbimi me rreth 75% të tij, i cili është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha qarqet e vendit, si edhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse.

Pas përqendrimit, pjesa e tregut e operatorit Albtelecom SHA do të mbetet e njëjtë, duke qenë se shoqëria blerëse 4iG Nyrtr nuk operon në këtë treg dhe si rrjedhim nuk do të kemi ndryshim të strukturës së tregut pas transaksionit.

Shërbimi i paketave të integruara, përmban shërbimin e aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) dhe rezulton të jetë segmenti më konkurrues midis operatorëve të rrjeteve fikse. Albtelecom SHA ka qenë ofruesi kryesor i këtij shërbimi, ndërkohë që gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile nga operatore të tjerë, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet.

Në përfundim të analizës konstatohet se, nisur nga fakti që shoqëria 4iG Nyrtr nuk operon dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zotëron shoqëria Albtelecom SHA në tregun përkatës të produktit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përftimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 856, Datë 21.01.2022

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES STAR PARKING ALBANIA SHPK NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).

Baza ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me vendimin nr. 816, datë 02.09.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Star Parking SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Star Parking SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport, për periudhën kohore i janar 2020 deri në 30 qershor 2021.
2. Në zbatim të këtij vendimit, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar ndërmarrjes Star Parking SHPK.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

3. Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
4. Në zbatim të VKK nr. 816, datë 02.09.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Star Parking SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport”, tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit nga

ndërmarrja Star Parking SHPK në Aeroportin “Nënë Tereza” (TIA).

5. Ndërmarrja Star Parking SHPK e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj ekonomike: sigurimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të parkimit me pagesë, e ka selinë e ndërmarrjes në Aeroportin “Nënë Tereza”, Nikël (Rinas), Durrës.
6. Për sa më sipër, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet Nikël (Rinas), në të cilin ndërmarrja Star Parking SHPK ushtron aktivitetin e shërbimit të parkimit me pagesë pranë Aeroportit “Nënë Tereza” (TIA).

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

7. Në bazë të nenit 3, pika 5 të ligjit nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”
8. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121/2003.
9. TIA ka nënshkruar një marrëveshje koncesioni me Republikën e Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare Tirana Airport Partners SHPK për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit “Nënë Tereza”, si dhe dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie.”
10. Në pikën 2.1.a (v) të ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar, i jep shoqërisë, të drejtën e vetme dhe ekskluzive që gjatë afatit të koncesionit të kryejë projektin në zonën e koncesionit dhe, pa kufizim, të drejtat për të: projektuar, financuar, operuar, ndërtuar, venë në punë, mirëmbajtur, administruar dhe zhvilluar Fazën A të Parkimit të Automjeteve dhe Fazën B të Parkimit të Automjeteve.
11. Nëpërmjet “Marrëveshjes së amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK në datë XXXX ka nënshkruar marrëveshjen me TIA për instalimin, finalizimin, azhornimin/zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e Faciliteteve të Parkimit si dhe shërbimin dhe pajisjen e karrocave në aeroportin “Nënë Tereza”, më një afat deri në XXXX.
12. Në bazë të “Marrëveshjes së amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK është subjekti i vetëm që menaxhon facilitetet e parkimit dhe shërbimet dhe pajisjet e karrocave pranë TIA.
13. Ndërmarrja Star Parking SHPK ka pozitë dominuese në aktivitetin ekonomik për ofrimin e shërbimit të parkimit me pagesë pranë TIA. Vlera e indeksit HHI (Herfindahl-Hirschman Index) për periudhën nën hetim, bazuar në pjesët e tregut në rastin një ndërmarrje me pozitë dominuese, është shumë e lartë, në vlerën 10 000. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka një pozitë dominuese duke patur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në ligj dhe në udhëzimin përkatës të pozitës dominuese, por edhe në praktikat më të mira të Komisionit European dhe të OECD, monopoli në këtë rast Star Parking Albania SHPK, është një mundësi potenciale që të shkaktojë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun përkatës

14. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK referuar “Marrëveshjes së amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”, menaxhon, pajis me personel dhe operon facilitetet e parkimit P1, P2, P3 dhe zonën përpara terminalit në afat të shkurtër, afat të mesëm dhe afat të gjatë kohor siç është parashikuar në Marrëveshje.
15. TIA ndër vite ka lidhur marrëveshje me ndërmarrjet si në vijim: (i) Ndërmjet TIA dhe MR.S.r.l & Supreme FM SHPK “Marrëveshja për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”: dhjetor XXXX me një afat 5 vjeçar me të drejtë shtyrje për 2 vjet, duke njoftuar 6 muaj përpara mbarimit të afatit 5 vjeçar; (ii) Ndërmjet TIA dhe Star Parking SHPK “Marrëveshja e amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”: XXXX - XXXX; (iii) Ndërmjet TIA dhe Star Parking SHPK “Marrëveshja e amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave”: XXXX - XXXX.
16. Marrëveshja e nënshkruar në vitin XXXX është me një afat më të gjatë (10 vjet) si dhe ndërmarrja Star Parking SHPK është subjekti i vetëm që menaxhon facilitetet e parkimit dhe shërbimet për pajisjet e karrocave pranë TIA, duke pasur një pozitë dominuese në tregun përkatës, në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003 përbën një pengesë për hyrjen e ndërmarrjeve të tjera apo operatorëve të tjerë për të ofruar të njëjtin shërbim.
17. Referuar informacionit të administruar nga Drejtoria e Licensimit dhe Certifikimit, pranë DPSHTRR rezulton se operatorët e licensuar për të operuar në tregun e transportit të udhëtarëve nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) janë:
 - i. Subjekti LUNA SHPK, Linja: Tiranë-Rinas (Aeroport) – Tiranë
 - ii. Subjekti EURO – ALBANIA TRAVEL SHPK Linja: Fier-Rinas (Aeroport) – Fier (nga Ura e Dajlanit – Vorë)
 - iii. Subjekti ADIS SHPK, Linja: Durrës-Rinas (Aeroport) – Durrës
 - iv. Subjekti HERMES AEROPORT SHPK, Linja: Vlorë-Rinas (Aeroport) – Vlorë (me kalim nga Fier, Lushnjë, Kavajë, Durrës, Vorë)
 - v. Subjekti HERMES AEROPORT SHPK, Linja: Shkodër-Rinas (Aeroport) – Shkodër.
18. Ndërmarrja Star Parking SHPK në vitin 2021 ka lidhur kontrata qeraje me ndërmarrjet që operojnë në tregun e transportit të udhëtarëve nga TIA (shërbim autobus) si vijon:
 - i. Balla Tours SHPK - Linja: Tiranë-Rinas (Aeroport) – Tiranë
 - ii. ADIS SHPK - Linja: Durrës-Rinas (Aeroport) – Durrës
 - iii. Luna SHPK - Linja: Tiranë-Rinas (Aeroport) – Tiranë
 - iv. Euro Albania Travel SHPK - Linja: Fier-Rinas (Aeroport) – Fier (nga Ura e Dajlanit – Vorë)
 - v. HERMES AEROPORT SHPK - Linja: Vlorë-Rinas (Aeroport) – Vlorë
19. Star Parking SHPK gjatë vitit 2020 ka lëshuar gjithsej XXXX telepas në vlerën totale prej XXXX lekë. Ndërmarrja Star Parking SHPK ofron telepas për 9 lloje të ndryshme shërbimesh siç janë: shërbimi i autobusëve, makina me qera, taxi, reklamim, shërbim bagazhesh etj.
20. Në vitin 2020, për shërbimin e autobusëve vetëm 4 ndërmarrje kanë marrë telepas të cilat janë: Luna SHPK, Euro Albania Travel, ADIS SHPK dhe Hermes Aeroport.

21. Të ardhurat nga telepasi për vitin 2020 zënë vetëm XXXX% të të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit.
22. Të gjitha ndërmarrjet në klasifikimin si shërbim autobusi kanë më shumë se një telepas në përdorim dhe vetëm ndërmarrja ADIS SHPK e ka përfituar me një vlerë më të ulët se ndërmarrjet e tjera duke marrë telepas me çmimin 6,000 lekë në muaj. Tre ndërmarrjet e tjera të shërbimit të autobusëve e kanë përfituar çmimin e një telepasi për 18,000 lekë në muaj.
23. Star Parking SHPK gjatë periudhës 1 janar 2021 - 30 qershor 2021 ka lëshuar gjithsej XXXX telepas në vlerën totale prej XXXX lekë. Si në vitin 2020, telepasët janë ofruar për 9 lloje shërbimesh ku përfshihen: shërbimi i autobusëve, makina me qera, kompani ajrore etj.
24. Për periudhën janar - qershor 2021, është rritur numri i ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e autobusëve në 6, krahasuar me 4 që ishin për vitin 2020. Këto ndërmarrje janë: Log In Albania SHPK, Green Motion Albania SHPK, Luna SHPK, Euro Albania Travel, ADIS SHPK dhe Hermes Aeroport.
25. Të gjitha ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e autobusëve në periudhën janar - qershor 2021 e kanë blerë telepasin me çmimin 18,000 lekë, përfshirë edhe ndërmarrjen ADIS SHPK.
26. Për vitin 2021 nuk mund të përcaktohet sa pjesë zënë të ardhurat nga telepasi në totalin e të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit, duke qenë se viti financiar 2021 mbyllet në muajin mars të vitit pasardhës.
27. Për përdorimin e facilitetit të Zona e Jashtme e Mbërritjeve, Star Parking SHPK për vitin 2020 ka lëshuar në total 9 telepas për ndërmarrjet që operojnë në transportin e udhëtarëve nga TIA, total në vlerën 138,000 lekë, si vijon:
 - Luna SHPK: 3 telepas, 18,000 lekë/copa
 - Euro Albania Travel SHPK: 2 telepas, 18,000 lekë/copa
 - Adis SHPK: 2 telepas, 6,000 lekë/copa
 - Hermes Aeroport: 2 telepas, 18,000 lekë/copa
28. Për përdorimin e facilitetit të Zona e Jashtme e Mbërritjeve, Star Parking SHPK për periudhën janar - qershor 2021 ka lëshuar në total 11 telepas për ndërmarrjet që operojnë në transportin e udhëtarëve nga TIA, total në vlerën 198,000 lekë, si vijon:
 - Log in Albania SHPK: 2 telepas; 18,000 lekë/copa
 - Green Motion Albania: 1 telepas; 18,000 lekë/copa
 - Luna SHPK: 3 telepas: 18,000 lekë/copa
 - Euro Albania Travel SHPK: 2 telepas; 18,000 lekë/copa
 - Adis SHPK: 1 telepas: 18,000 lekë/copa
 - Hermes Aeroport: 2 telepas; 18,000 lekë/copa
29. Ndërmarrja Star Parking SHPK argumenton se kostot e rritura ndër vite (kosto mirëmbajtes parkimi, investime në parkimin P3, tarifat e koncesionit etj) kanë ndikuar në vendimin e marrë për të rritur çmimin e telepaseve për subjektet e treta.
30. Referuar pikës 19.1 (a) të marrëveshjes thuhet se: TIA do të zhvillojë dhe ndërtojë hapësira parkimi shtesë e cila do të jetë Faciliteti i Parkimit P3 si dhe do të mbulojë Facilitetin e Parkimit P2 gjatë Afatit të kësaj Marrëveshje. TIA do t'i japë Star Parking SHPK të drejtën e operimit të hapësirës shtesë të parkimit me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje. TIA do të njoftojë Star Parking SHPK të paktën një

muaj përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e Facilitetit të Parkimit P3 dhe mbulimin e Facilitetit të Parkimit P2. TIA do të njoftojë gjithashtu OPK të paktën një muaj përpara datës së Dorëzimit të Facilitetit të Parkimit P3 dhe Facilitetit të Mbuluar të Parkimit P2. Për shmangie të çdo dyshimi, gjatë ndërtimit të Facilitetit të Parkimit P3 dhe mbulimit të Facilitetit të Parkimit P2, Star Parking SHPK nuk do të ngrejë ndonjë pretendim në lidhje me uljen e të ardhurave për shkak të ndërtimit.

31. Nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet TIA dhe Star Parking mbi të drejtat që i janë dhënë nga TIA, Star Parking është subjekt i Marrëveshjes së Koncesionit dhe si i tillë konsiderohet se është këshilluar në lidhje më të dhe është në dijeni të plotë të kushteve të saj, dhe ka marrë përsipër të zbatojë detyrimet e TIA-s të cilat lidhen me Operimin e Faciliteteve të Parkimit dhe Shërbimeve dhe Pajisjeve të Karrocave.
32. Ndërmarrja Star Parking SHPK ka pozitë dominuese prej 100% në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit pranë TIA. Bazuar në praktikat më të mira të Komisionit Evropian dhe të OECD, monopoli krijon mundësi potenciale për abuzim të pozitës dominuese në tregun përkatës.
33. Në bazë të nenit 9 pika 2, shkronja (a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes, përbën abuzim me pozitën dominuese. Sipas interpretimit të konsoliduar të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, abuzim i pozitës dominuese në këtë kuptim do të thotë “vendosja e një çmimi që është i lartë në mënyrë të paarsyeshme në raport me vlerën ekonomike të produktit apo shërbimit të ofruar”.¹
34. Përcaktimi nëse një çmim është i lartë në mënyrë të paarsyeshme, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe praktikës së Komisionit Evropian, kryhet në mënyrë objektive me anë të krahasimit të çmimit të shitjes së produktit apo shërbimit specifik dhe kostos së prodhimit të tij.² Nëse diferenca mes tyre (fitimi) është e tepërt, atëherë vlerësohet nëse është e padrejtë, në vetvete apo në krahasim me produkte ose shërbime konkurruese.
35. Star Parking SHPK në korrik të vitit 2020 rriti çmimin për telepas nga 6,000 lekë/telepas në muaj në 18,000 lekë/telepas në muaj duke e argumentuar me rritjen e shpenzimeve të riparimeve dhe të mirëmbajtjes përgjatë atij viti. Kjo shoqëri ka bërë të ditur Marrëveshjen e amenduar dhe rikonfirmuar për parkimin e makinave dhe shërbimin e karrocave ndërmjet Star Parking dhe TIA, si dhe kostot e përgjithshme të lidhura me të gjithë aktivitetin ekonomik të saj në bazë të kësaj marrëveshje. Ndërkohë, të ardhurat nga telepasi sipas të dhënave të marra për vitin 2020, përbëjnë vetëm 2.3% të të ardhurave të përgjithshme, duke mos patur kështu një rol parësor në gamën e gjerë të shërbimeve të ofruara nga kjo shoqëri.
36. Për rrjedhojë, është thelbësore që Autoriteti i Konkurrencës të disponojë informacion mbi kostot e lidhura specifikisht me telepaset, në mënyrë që të bëhet një analizë objektive nëse ka një abuzim me pozitën dominuese, bazuar në nenin 9, pika 2, shkronja (a), e ligjit nr. 9121/2003 pasi ka dyshim për kufizim të mundshëm të konkurrencës në treg nëpërmjet vendosjes së çmimeve të padrejta.
37. Star Parking SHPK në kontratën e qerasë të lidhur me ndërmarrjen ADIS SHPK e cila operon në tregun e transportit të udhëtarëve nga TIA (shërbim autobus), ka përcaktuar kushte të pabarabarta nga ndërmarrjet e tjera duke përcaktuar targën me nr. e telpasit përkatës (Nr. AA521SR/132432) sipas të cilit është i lejuar të futet në hapësirat e parkimit, ndryshe nga ndërmarrjet e tjera për të cilat lejon që në hapësirat e parkimit të makinave klientët e saj dhe të punonjësve të saj në detyrë, si dhe ka përcaktuar vetëm për ndërmarrjen ADIS SHPK penalitetin e një vlerë 125 euro (me TVSH) që i paguhet Star Parking SHPK në rast të humbjes së telepasit, kjo sjellje e ndërmarrjes Star Parking SHPK në kuptim të nenit 9, pika 2, shkronja

¹ Case 26/75 General Motors v Commission EU:C:1975:150, p. 12.

² Case 27/76 United Brands v Commission EU:C:1978:22, p. 251-252.

(c) e ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëj abuzim me pozitën dominuese duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2021.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 857, Datë 21.01.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ELMTRONICS GROUP LIMITED NGA SHOQËRIA MER UK HOLDING LIMITED”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Eltronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Eltronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Eltronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjithë aksioneve të emetuara të kapitalit të Eltronics Group Limited”, të lidhur më datë [.....], palët janë:

Blerësi: Mer UK Holding Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjin anglez, me objekt veprimtarie: zotërimi, furnizimi, instalimi dhe operimi i pikave të karikimit të automjeteve elektrike për klientë në UK si për përdorim publik ashtu edhe për privat.

Mer UK Holding Limited është një filial i shoqërisë Statkraft AS, e cila është një shoqëri globale me seli në Norvegji, aktive në prodhimin dhe tregtimin e energjisë së rinovueshme.

Shoqëria Statkraft AS është e pranishme në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara indirekt prej saj:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to etj.

Devoll Hydropower SHA, shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shitësit:

1. Enterprise Ventures (General Partner NE Venture) Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjin anglez, e cila ofron financime të sipërmarrjes, të kapitalit privat apo borxhit për bizneset lokale në UK.
2. TT Nominees Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjin anglez, e cila ofron shërbime për sipërmarrjen, duke përfshirë krijimin e fondeve, strukturimin e investimeve dhe shërbimeve të aksionareve të emëruar për fondet, firma të korporatave financiare dhe platformave të financimeve kolektive.
3. The North East (ERDF) Venture Capital Limited Partnership, është një shoqëri me partneritet të kufizuar dhe vepron nëpërmjet partnerit të tij kryesor Enterprise Ventures (General Partner NE Venture) Limited.
4. Shtatë persona fizik, shtetas të huaj.

Referuar pikës D të Marrëveshjes: Shoqëria Ingenious Capital Management Limited është palë e kësaj marrëveshjeje për qëllimet e dhënies së pëlqimit të saj për transaksionet e parashikuara nga kjo marrëveshje dhe për të realizuar transferimin e titullit përfitues të aksioneve Ingenious (titulli ligjor i të cilave mbahet nga shoqëria TT Nominees Limited).

Shoqëria Target: Elmtronics UK Holding Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjin anglez, me objekt aktiviteti: furnizimin dhe instalimin e pikave të karikimit të makinave elektrike si për konsumatorë ashtu edhe për klientë tregtarë.

Targeti dhe filialet e tij nuk kanë asnjë aktivitet dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi

Më datë [...], shitësit; shoqëria Ingenious Capital Management Limited dhe shoqëria Mer UK Holding Limited kanë nënshkruar “Marrëveshjen lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjithë aksioneve të emetuara të kapitalit të Elmtronics Group Limited”.

Referuar kësaj marrëveshjeje, [...].

Pas përfundimit të transaksionit, [...].

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i biznesit të karikimit të automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfthimi i kontrollit të shoqërisë Elmtronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited, shoqëri e cila operon në tregun e shërbimit të pikave të karikimit të automjeteve elektrike për klientë në UK si për përdorim publik ashtu edhe për privat.

Shoqëria Mer UK Holding Limited, kontrollohet nga grupi Statkraft AS, i cili realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet filialeve të zotëruara në mënyrë indirekte, Devolli Hydropower SHA dhe shoqërinë Statkraft Renewable Albania SHPK, që operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore.

Elmtronics Group Limited nuk ka prani dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përftimi i kontrollit të shoqërisë Elmtronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 858, Datë 21.01.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË VOITH HYDRO HOLDING VERWALTUNGS GMBH NGA SHOQËRITË E GRUPIT VOITH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të 35% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH nga shoqëria JMV Hydro Beteiligungen GmbH.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të 35% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH nga shoqëria JMV Hydro Beteiligungen GmbH,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi blerjen e 35% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH nga shoqëria JMV Hydro Beteiligungen GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e Blerjes dhe Transferimit të aksioneve” të lidhur më datë [...] palët janë:

Shitësi: Siemens Energy Global GmbH & Co.KG, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Gjermani, shoqëri e grupit Siemens AG dhe zotëuese e 35% të kapitalit të shoqërisë target. Siemens AG është një nga shoqëritë kryesore për prodhimin e energjisë, që ofron zgjidhje të avancuara në lidhje me të.

Blerësi: JMV Hydro Beteiligungen GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Gjermani, me objekt aktiviteti blerjen dhe administrimin e aksioneve në Voith Hydro Holding GmbH & Co.KG dhe në Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH.

[....].

Target: Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjermani. Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH furnizon të gjithë komponentët për hidrocentrale të mëdha e të vogla. Shoqëria target zotërohet në 65% të kuotave të saj nga Voith Hydro Beteiligungen GmbH, një shoqëri gjermane, pjesë e Grupit Voith.

Grupit Voith është i angazhuar në prodhimin dhe shitjen e makinerive të letrës, pajisjeve hidroenergjetike, teknologjisë së transmetimit dhe drejtimit për automjetet tregtare dhe autobusët etj.

Grupi Voith nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por ka deklaruar të ardhura të realizuara në tregun e brendshëm, në Shqipëri.

Në 16 shkurt 2000 lidhet një marrëveshje mes Siemens AG; JM Voith SE&CO. KG dhe Voith GmbH&CO.KGAA, e cila kishte për qëllim krijimin një sipërmarrje të përbashkët e quajtur Voith Siemens Hydro Power Generation GmbH&CO.KG (sot Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH, shoqëria targeti).

Kjo marrëveshje u njoftua pranë Komisionit Evropian dhe në vendimin Comp /M.1793-Voith /Siemens/JV, sqarohet se, *për shkak të njësive përkatëse të biznesit të sjellë, Voith do të mbajë 65% dhe Siemens 35% të aksioneve të sipërmarrjes së përbashkët. Siemens dhe Voith synojnë të ndajnë njësitet përkatëse të hidrocentraleve duke i bashkuar në një sipërmarrje të re të përbashkët. Voith do të sjellë fushën e pajisjeve mekanike (turbinat e ujit, kontrollin dhe shërbimin) dhe Siemens zonën e pajisjeve elektrike (gjeneratorë, kontroll dhe shërbim) në mënyrë që palët të mos jenë më aktive në zonën e hidrocentraleve edhe pas bashkimit.*

Gjithashtu në pikën 6 të vendimit, përcaktohet se: *“Sipërmarrja e përbashkët kontrollohet bashkërisht nga palët, pasi sipas statutit dhe rregullores së Bordit Këshillimor, të gjitha vendimet strategjike merren unanimisht në një bord këshillues të krijuar nga Voith (4 anëtarë) dhe Siemens (2 anëtarë) që përfaqësojnë mbledhjen e aksionarëve.”.*

Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit midis ndërmarrjeve”, pika 3.2 është përcaktuar se “Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësimin në organet vendimmarrëse. Këto të drejta mund të vendosen në statutin e joint venture ose të jepen nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve mëmë. Këto të drejta vetoje duhet të lidhen me vendime strategjike mbi politikën e biznesit të sipërmarrjes së përbashkët/ JV”.

Kontrolli i përkufizuar sipas nenit 10 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, përcaktohet si një mundësi për të ushtruar influencë vendimtare mbi një ndërmarrje. Mundësia për të ushtruar influencën vendimtare mbi një ndërmarrje mund të ekzistojë mbi bazën e të drejtave, kontratave apo mjeteve të tjera, veçmas ose në kombinim. Duke patur parasysh faktet dhe referuar VKE M.1793, shoqëria Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH kontrollohej bashkërisht nga shoqëritë Voith Hydro Beteiligungen dhe Siemens Energy Global GmbH.

Më datë [...], shoqëritë Siemens Energy Global GmbH & Co.KG; JMV Hydro Beteiligungen GmbH; Voith GmbH & Co.KGAA; Voith Hydro Beteiligungen GmbH dhe J.M Voith SE & Co.KG, kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshja e Blerjes dhe Transferimit të Aksioneve”. Referuar kësaj Marrëveshje, Grupi Voith do të zotërojë në mënyrë indirektë 100% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding GmbH&CoKG dhe partnerit të saj të përgjithshëm Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH, nga të cilat [...]

Transaksioni i propozuar përbën një ndryshim kontrolli mbi të drejtën e vetos, përfitim i kontrollit të vetëm nga Grupi Voith, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore.

Mbështetur në pasqyrat financiare të depozituara dhe deklaratat e përfaqësuesit ligjor mbi xhiron në Shqipëri, konstatohet plotësim edhe i kriterit të përcaktuar në nenin 12 të ligjit, dhe si i tillë ky transaksion kërkon autorizimin nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i furnizimit me të gjithë komponentët për hidrocentrale dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave

të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është blerja e 35% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH nga shoqëria JMV Hydro Beteiligungen GmbH, shoqëri e grupit Voith. Pas transaksionit Grupi Voith do të zotërojë 100% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH, duke fituar të drejtën e kontrollit të vetëm mbi shoqërinë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH.

Duke qenë se palët në marrëveshje nuk kanë filial apo degë në Shqipëri, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në strukturën e tregut në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të 35% të aksioneve të shoqërisë Voith Hydro Holding Verwaltungs GmbH nga shoqëria JMV Hydro Beteiligungen GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 859, Datë 21.01.2022

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTËR SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për miratimin dhe unifikimin e tarifave për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për miratimin dhe unifikimin e tarifave për Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 491 prot., datë 16.12.2021, informon Autoritetin e Konkurrencës se me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 289 prot., datë 15.07.2021, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë unifikimin dhe miratimin e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për miratimin e tarifave si edhe projekt-vendimin përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër SHA”, rezultoi si vijon.
3. Aplikimi i metodologjisë për miratimin e tarifave dhe unifikimi tarifar ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e treguesve të performancës, e cila tregon për miratimin e tarifave për herë të parë pas dy vitesh të licensimit të UK Mallakastër SHA, për kategorinë e furnizimit me ujë, shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, tarifat fikse për ofrimin e të dy shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. UK Mallakastër SHA ka aplikuar tarifat të pa miratuara nga ERRU, duke mos zbatuar pikën 3 të kreut II të VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, për miratimin e tarifave në momentin e licensimit të UK Mallakastër SHA, pas riorganizimit. Në këto kushte UK Mallakastër SHA kërkon të aplikoj një tarifë të miratuar dhe të unifikuar në të gjithë zonën e shërbimit, për të siguruar shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve si OSSH dhe ARMO, në përballimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes dhe ruajtjen e një niveli të cilësisë së shërbimit.

5. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivele tarifimi volumetrik shërbimi për FU edhe për KUN të cilat do të jenë të pandryshuara. Këto tarifa për FU janë aplikuar për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga UK Mallakastër SHA pas riorganizimit administrativ.
6. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Mallakastër SHA propozon miratimin e tarifave dhe unifikimin e tyre, pasi UK Mallakastër SHA aplikon tarifa të pa miratuara nga ERRU që nga licencimi në vitin 2019. UK Mallakastër SHA është një shoqëri e cila bën pjesë në grupin e shoqërive të dobëta financiarisht me nivel të ulët të mbulimit të Kostove O&M prej 46% e cila kërkon të ofroj përmirësim të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.
7. UK Mallakastër SHA kërkon të miratoj ato tarifa volumetrike për KUN (largimin e ujërave të ndotura) për të tre konsumatorët familjar, publike dhe private që aplikon aktualisht për këtë shërbim. Tarifat është 10 lek/m³ dhe kërkohet të miratohet po në këto nivele për të tre konsumatorin familjarë, konsumatorin publik dhe për konsumatorin privat. Përcaktimi i tarifës fikse të shërbimit është kërkuar të miratohet aq sa ajo aplikohet aktualisht 100 lekë/muaj për konsumatorët familjar dhe 200 lekë/muaj për konsumatorin publik dhe privat.
8. ERRU ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjetës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbroj konsumatorët nga çmimet monopol; të inkurajoj efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktët; duhet të pasqyrojë hapur dhe qartë subvencionet e dhëna nga Këshilli i Ministrave; duhet të pasqyrojë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis klasave të klientëve dhe llojeve të shërbimit, në varësi të subvencioneve që do të aplikohen.
9. ERRU ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”. Bazuar në këtë metodologji shqyrtimi i aplikimit për miratimin dhe unifikimin e tarifës fillon me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe analizën e treguesve të performancës. Rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet në përmirësimin e performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve për të cilat ato aplikohen, kosto të cilat duhet të jenë të nevojshme për marrjen e këtyre shërbimeve, nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe transparencës në realizimin e investimeve si edhe të subvencioneve të marra, por nuk rezulton nga analiza e treguesve të këtyre investimeve që do të ndikojnë në cilësinë e shërbimit nga UK Mallakastër SHA, gjithashtu subvencionet nuk kanë qenë pjesë e analizës ekonomike, në kundërshtim me nenin 21 pika 2 (e) dhe 2 (f) të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.
10. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, niveli i kostove për vitin 2020 dhe vitin 2021 referuar treguesve të performancës nuk tregon ndonjë rritje evidente, që UK Mallakastër SHA të mund të përfitoj investime për përmirësimin e rrjetit të ujësjetës dhe KUN në të gjithë zonën. UK Mallakastër SHA nuk ka menaxhuar punën për reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore, faturimin mbi bazën e matësve, rritjen e nivelit të menaxhimit, reduktimin e numrit të punësuarve për 1000/lidhje, i cili rezulton të jetë shumë i lartë në krahasim me UK-të e tjera.

11. Ndarja e kostove të këtyre shërbimeve për secilën zonë individuale do të siguronte një analizë më të saktë dhe vendosje të tarifave më të drejta. Për vlerësimin e kostove së arritshme të një ndërmarrjeje UK, rregullatori ka përdorur si bazë kostot sipas zonave, duke siguruar një nivel të arsyeshëm tarifash në raport me shërbimin e ofruar si dhe nivelin e mbulimit të shërbimit, burimet alternative të përdorimit etj. Kjo ka sjellë vendosjen e tarifave në nivele thuajse të afërta me UK e tjera, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmim të lartë për produktin dhe shërbimin që u ofrohet në raport me treguesit e performancës, duke argumentuar këtë ndërmarrje në vështirësi për shkak të detyrimeve ndaj OSSH dhe ARMO-s.
12. ERRU-së për vitin 2021 dhe vitin 2022 synon përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e efikasitetit në reduktimin e numrit të stafit, i cili është i lartë, 15 staf/1000/lidhje, rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruara.
13. ERRU nuk i ka miratuar tarifat për ofrimin e shërbimeve eficientë nga vitit 2019 deri më sot për UK Mallakastër SHA. Bazuar në nenin 13 të Vendimit nr. 42, datë 09.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” për ofrimin e shërbimeve eficientë, ERRU kërkon që UK Mallakastër SHA të ketë shpenzime O&M “të arsyeshme dhe të nevojshme” me synimin që konsumatorët të paguajnë vetëm kosto të justifikuara.
14. Nga analiza ekonomiko-financiare, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër SHA pas riorganizimit sipas nenit 14 të Vendimit të KKRR nr. 42, datë 09.12.2015 analiza e vlerësimit të performancës bazohet në disa tregues krahasimi. Treguesit e mosrealizimit nga UK Mallakastër SHA nga viti 2017 deri më sot kanë çuar në një vlerësim të ulët të performancës pasi UK Mallakastër SHA nuk është në gjendje të mbulojë me shumë se 56% të kostove të operimit & mirëmbajtjes.
15. Informacioni mbi aplikimin për miratimin e tarifave nuk është bërë transparent në faqen e ERRU-së të miratuar si fillim procedure me Vendimin e KKRR-së nr. 289, datë 15.07.2021, duke mos marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, nëpërmjet të cilit kërkohet nga ERRU: “Publikimi dhe bërja transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime për vitet 2019 dhe 2020, të publikuara me treguesit e parashikuar për “Ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Efikasitetin e stafit”.
16. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të evidentojë të gjitha lidhjet me rrjetin, të marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, nivelin e debive dhe rritjen e investimeve për të përmirësuar shërbimin në kuadër të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” me qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.
17. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Mallakastër SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
18. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2021 mbetet thuajse në nivele relativisht të ulta krahasuar me ato të vitit 2020 me një rritje rreth 0.7%, subvencionet që përfiton kjo ndërmarrje për mbulimin e

kostove, përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit duhet të jenë transparente, të kontabilizohen dhe të merren në konsideratë për vlerësimeve e kostove.

19. Nga vlerësimi i konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Mallakastër SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Mallakastër SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për unifikimin e tarifës dhe nivelin e ri të tarifës për FU dhe KUN, UK Mallakastër SHA ka realizuar ndarjen veç e veç të kostove sipas shërbimit FU dhe KUN, pavarësisht se tarifat nuk kanë qenë të miratuara.
20. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot të ndara për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e), por nuk ka pasqyruar subvencionet dhe investimet e përfituara aktualisht nga kjo ndërmarrje.
21. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për miratimin e tarifave nuk është bërë transparent në faqen e ERRU-së, nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

38. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
- a) Të bëhet transparente në faqen e web-it të ERRU –së e gjitha praktika e vlerësimit dhe miratimit të tarifave për UK Mallakastër SHA.
 - b) Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Mallakastër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mos diskriminimit,
 - c) ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Mallakastër SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar, paraqitjen e subvencioneve të përfituara duke njoftuar Autoritetin e Konkurrencës brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - d) ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos duke përfshirë dhe subvencionet dhe investimet e përfituara.
39. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 860, Datë 31.01.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË DISA ASETEVE TË SHOQËRISË AUTOMOBIL-LOGISTIK-MOSOLF GMBH NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN GROUP SERVICES GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi blerjen e disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e blerjes dhe transferimit për asetet e Automobil-Logistik-Mosolf GmbH” (Pjesa B e kontratës), palët janë:

Blerësi: Volkswagen Group Services GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve me kontratë pune, veçanërisht të natyrës teknike dhe tregtare, kryesisht për shoqëritë e Grupit Volkswagen.

Volkswagen Group Services GmbH është një filial i shoqërisë Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila ka objekt aktiviteti: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike dhe është shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të

tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Shitësi: Automobil-Logistik-Mosolf GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zbatimin dhe ofrimin e shërbimeve për mjetet motorike si p.sh. shërbimet e ruajtjes, magazinimit etj, transporti special i automjeteve të të gjitha llojeve, blerja dhe shitja e automjeteve, si dhe kryerja e të gjithë transaksioneve në Gjermani dhe jashtë saj që lidhen ligjërisht dhe ekonomikisht me aktivitetet e mësipërme. Shoqëria Automobil-Logistik-Mosolf GmbH i përket Grupit Mosolf.

Grupi Mosolf është ofrues i shërbimeve të sistemit për industrinë e automobilave në Evropë.

Asetet e Target ndodhen dhe realizojnë të ardhura vetëm në Gjermani dhe aktualisht janë në pronësi të shitësit Automobil-Logistik-Mosolf GmbH.

Përqendrimi

Më datë [.....], shoqëritë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH (ALM) dhe Volkswagen Group Services GmbH kanë nënshkruar Pjesën B të Kontratës “Marrëveshja e blerjes dhe transferimit për asetet e Automobil-Logistik-Mosolf GmbH”.

Me anë të kësaj kontrate shitësi shet [.....].

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.

Asetet e target mundësojnë [.....].

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, [.....].

Transaksioni i propozuar synon përfkrimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH dhe plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është blerja e aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Volkswagen Group Services GmbH është një filial i Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Asetet e target nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 861, Datë 31.01.2022

“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË THELLUAR PËR VLERËSIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA TELECOM INVEST AD NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Baza ligjore: Nenet 2, 9, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzuesit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

Shoqëria zotërohet [...].

Shoqëria 4iG Nyrt zotëron 80.27% të kuotave të shoqërisë Altelecom SHA, e cila ofron shërbime në tregun e komunikimeve elektronike.

Pala shitëse:

Shitësit 1: ATI Albanian Telecom Invest LTD, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Qipros, e cila është krijuar me qëllim për të krijuar e vetme ose në bashkëpunim me të tjerë në çdo vend të botës biznesin e një shoqërie investimesh, etj.

Shitësi 2: Adarna Eood, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.

Shitësi 3: Guri Enterprises B.V, e cila është një shoqëri me formë ligjore të krahasueshme me një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Hollandës. Guri Enterprises B.V, është një shoqëri financiare holding.

Shitësi 4: River Styxx Capital EAD, është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.

Shoqëria Target: Albania Telecom Invest AD (ATI), është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: investime dhe aktivitete në fushën e telekomunikacioneve si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohet nga legjislacioni i Republikës së Bullgarisë.

Shoqëria Albania Telecom Invest AD, është zotëruese e 99.899% të aksioneve të shoqërisë One Telecommunications SHA.

Filiali: *One Telecommunications SHA*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM, të ofrojë shërbimin e roamingut ndërkombëtar, etj.

Shoqëria zotërohet në 99.899% të aksioneve nga Albania Telecom Invest AD dhe pjesa e mbetur zotërohet nga 5 aksionerë të ndarë në përqindje pjesëmarrje, nën 0.03% të aksioneve.

Përqendrimi

Ndërmjet, shoqërisë 4iG Nyrt (blerësi) dhe shitësve ATI Albanian Telecom Invest LTD , Adarna Eood, Guri Enterprises B.V dhe River Styxx Capital EAD është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh” në lidhje me shitblerjen 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Albania Telecom Invest AD, në datë [...].

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësit do të shesin të gjitha aksionet që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD. Shoqërisë Albania Telecom Invest AD, zotëron 99.899% në kapitalin aksioner të shoqërisë One Telecommunications SHA dhe pas përfundimit të transaksionit, shoqëria 4iG Nyrt do të fitojë kontrollin e vetëm të shoqërisë Albania Telecom Invest AD dhe shoqërisë One Telecommunications SHA,

Përfundimi i transaksionit do të kushtëzohet me plotësimin e kushteve nga Autoriteti i Konkurrencës, AKEP dhe plotësimin e kushtit të pëlqimit nga OTP Bank.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar, konstatohet se Marrëveshja e njoftuar, shkakton një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD dhe filialit të saj One Telecommunications SHA, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Analiza e Konkurrencës

Referuar palëve në marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, si dhe tregjeve të prekura nga transaksioni i synuar, bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i

produktit, do të jetë tregu i komunikimeve elektronike (nëpërmjet rrjeteve fikse dhe celulare) dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i komunikimeve elektronike është një treg i cili mbikëqyret dhe rregullohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Transaksioni i synuar do të sjellë përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë 4iG Nyrtr mbi shoqërinë Albanian Telecom Invest AD dhe indirekt mbi shoqërinë ONE Telecommunications SHA, duke përfituar pjesën e tregut që shoqëria ONE zotëron në tregun e komunikimeve elektronikë.

Shoqëria 4iG Nyrtr sapo ka hyrë në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, pas mbylljes së marrëveshjes për përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA, transaksion i autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, dhe nëpërmjet transaksionit të ri të njoftuar, shoqëria 4iG Nyrtr po synon të marrë kontrollin e një konkurenti të afërt të shoqërisë Albtelecom SHA.

Transaksioni i propozuar pritet të sjellë bashkim mes dy operatorë në treg, duke reduktuar numrin e operatorëve celularë në 2, (Vodafone dhe operatori i bashkuar).

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, i cili mund të krijojë pozitë dominuese të palëve në marrëveshje dhe mund të sjellë mbivendosje të aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar.

Referuar nenit 10, pika 1, germa a), nenit 56, pika 1 germa b) të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzuesit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve”, për vlerësimin e transaksionit të përfimit të kontrollit të plotë të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyrtr, vlerësohet fillimi i procedurës së thelluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1, germa b) dhe nenit 57 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së thelluar për vlerësimin e transaksionit të ndodhur nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.
2. Raporti i procedurës së thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së këtij vendimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 862, Datë 31.01.2022

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJES
VODAFONE ALBANIA SHA NË TREGUN E SHËRBIMEVE CELULARE: TREGU ME
SHUMICË I TERMINIMIT TË THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Baza ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Neofone SHPK me shkresën protokolluar pranë AK me 404 prot., datë 08.09.2021, ka depozituar ankesën mbi abuzimin me pozitën dominuese nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
2. Në vijim të ankesës së depozituar, me anë të shkresës nr. 404/1 prot., datë 20.12.2021 “Mbi shqyrtimin e ankesës”, në bazë të nenit 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar si dhe nenit 28, 29 të Rregullores së Funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja Neofone SHPK në datën 06.01.2022 është ftuar për një seancë dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës për tu dëgjuar mbi shkeljet e pretenduara.
3. Ndërmarrja Neofone SHPK, sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara në nenet 13,14 dhe 15 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kuadrit rregullator në fuqi në zbatim të këtij ligji është e regjistruar në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, sipas Autorizimit të Përgjithshëm nr. 2012-AP-U60-8-7, datë 12.03.2012 dhe Autorizimit Individual 2012-QP-U60-8-9, datë 13.07.2012.
4. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA, ndër të tjera ushtron edhe veprimtarinë për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i operatorit tranzitues drejt pajtimatrëve të Vodafone Albania.
5. Ndërmarrja Neofone SHPK në vitin 2012 ka lidhur një marrëveshje Interkoneksioni me ndërmarrjen Vodafone Albania SHA “Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike midis Vodafone Albania SHA dhe Neofone SHPK, datë 1.10.2012”, referuar si “Marrëveshja 2012” dhe tarifa për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare u përcaktua 6.2 lek/min, më një limit prej 160 mijë minuta/muaj

dhe 32 kanalet e aksesit u ndërpre në vetëm 16 kanale.

6. Ndërmarrja Neofone SHPK ka pranuar dhe përdorur kapacitetin e ofruar nga Vodafone Albania SHA që prej datës 01.10.2012 deri në 10.04.2015, ku u ndërpre aksesit dhe interkoneskioni me Vodafone SHA, pasi Vodafone për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga operatori Neofone SHPK nga 6.2 lek/min e rriti në vlerën 29.8 lek/min, pa dhënë asnjë argument dhe arsyetim.
7. Pas njoftimit të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA për aplikimin e tarifës së re për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania, Neofone SHPK ka kundërshtuar rritjen e tarifës pasi ishte 5 herë (480%) me e lartë se tarifa e negociuar dhe firmosur në marrëveshjen e tetor 2012 por Vodafone Albania SHA nuk ka pranuar të anuloj dhe as të negociojë tarifën por ka ndërprerë aksesin.
8. Ndërmarrja Neofone SHPK duke nisur nga data 10.04.2015 dhe në vazhdim është përballur me kushte të vështira tregtare si pasojë e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA, duke mos pasur mundësi të zhvillojë aktivitetin si tranzitues i trafikut ndërkombëtar për të cilin ishte licensuar që prej datës 13.07.2012 sipas Autorizimit 2012-AP-U60-8-9.
9. Në dhjetor të vitit 2015 Neofone SHPK i është drejtuar AKEP për të zgjidhur mosmarrëveshjen midis Neofone dhe Vodafone Albania por AKEP ka njoftuar se ka vendosur mos pranimin e shqyrtimit të ankimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pasi shërbimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ishte derregulluar nga AKEP kështu çdo marrëveshje e mundshme e lidhur ndërmjet palëve është plotësisht e ndërtuar mbi baza komerciale.
10. Në vitin 2015, Neofone SHPK ka paditur AKEP pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me shkresën e drejtuar për marrjen e masave për rivendosjen e të drejtës së cenuar dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2016 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e palës së paditur që të nxjerrë aktin administrativ në lidhje me ankimin e ndërmarrjes Neofone SHPK si dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në vitin 2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
11. AKEP në vitin 2019 me vendimin nr. 35, datë 14.10.2019 vendosi mos pranimin e ankimit të sipërmarrësit Neofone SHPK për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Neofone SHPK dhe Vodafone Albania SHA, duke argumentuar se Vodafone Albania nuk ka status me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe asnjë prej detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008 për këto thirrje, dhe AKEP nuk mund të detyrojë Vodafone Albania të lidhë marrëveshje aksesit/interkonkesioni me një operator tranzitues për terminimin e këtyre thirrjeve dhe as të rregullojë/përcaktojë tarifën e këtij shërbimi, përfshirë në procedura zgjidhje mos-marrëveshjeje.
12. Ndërmarrja Neofone SHPK në vitin 2020 ka paditur përsëri AKEP pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me Vendimin nr. 35/2019 dhe Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe çështja ndodhet pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
13. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është një shërbim me shumicë, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t'u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular.
14. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “*Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar*”, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin nr. 79, datë 01.10.2018 ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a me Fuqi të Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të

thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 01.10.2018 përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom SHA dhe sipërmarrësin Telekom Albania SHA me Fuqi të Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.

15. Të tre sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom u shpallën me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, dhe u vendosën masat përkatëse rregullatore për detyrimin e mosdiskriminimit dhe detyrimin e transparencës.
16. AKEP me vendimin nr. 89, datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e vendimit nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr. 79, nr. 80, nr. 81 dhe nr. 82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. 78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP. Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri me legjislacionin e Komisionit Evropian.
17. Këshilli Drejtues i AKEP-it me vendimin nr. 10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”. Lidhur me këtë dokument, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 634, datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare””, vendosi t’i rekomandojë AKEP si vijon:
 - i. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
 - ii. Vendosjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
 - iii. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.
18. AKEP me vendimin nr. 11, datë 16.06.2020 “Mbi përfundimet e arritura pas Këshillimit Publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, vendosi:
 - i. T’i konsiderojë tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi:
 - a) Masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 12, 13, 14, datë 22.2.2018.
 - b) Tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 01.10.2018.

- ii. Të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.
19. Në vendimin e AKEP sa më sipër, lidhur me tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, në pikën 11, është shprehur se: Përfitimi i modelit të kostove dhe për rrjedhojë i një mekanizmi eficient njësimi tarifar (glide path) do të mundësojë në momentin më të përshtatshëm një analizë të plotë rregullatore për sa i takon terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. KD është i vetëdijshëm për rëndësinë e zgjatjes së intervaleve kohore mes dy analizave, nga 3 në 5 vjet, rishtazi të rekomanduara nga Komisioni Evropian, për t'i dhënë kohën e mjaftueshme tregjeve për të strukturuar një fizionomi të qëndrueshme dhe për t'i lejuar rregullatorit të vrojtojë dhe të shqyrtojë kushtet e posaçme dhe dinamikat e tyre reale, duke shmangur çdo analizë skematike. Duke marrë parasysh sa më sipër, AKEP nuk do të ngurojë, sapo të disponojë një model kostosh tërësisht operacional, të shqyrtojë mundësinë e një analize të re të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke pasur parasysh faktorët ekonomikë specifikë, dinamikat e tregut shqiptar, eventualisht rekomandimet dhe direktivat e reja që mund të përpunohen nga Komisioni Evropian dhe impaktin mbi përdoruesit fundorë.
20. Objekti i ankesës së depozituar pranë AK nga ndërmarrja Neofone SHPK është nisja e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA për abuzimin e pozitës dominuese në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, ndërsa objekti i padisë në gjykatë nga Neofone SHPK është detyrimi i të paditurit AKEP, për nxjerrjen e aktit administrativ dhe marrjen e masave dhe rivendosjen e të drejtës së cënuar, pra objekti i të dy kërkesave nuk është i njëjtë.
21. Për sa më sipër, nisur nga problematika e ngritur, sjellja e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA mund të përbejë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës bazuar në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
 - II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 10 prill 2015 deri në 31 dhjetor 2021.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 863, Datë 15.02.2022

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.02.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 29/1 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e ankesës së paraqitur nga ndërmarrjet: ALCERT SHPK, ECIT SHPK, SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK, ST2 SHPK, M.F.M SHPK, lidhur me pasojat në treg të krijimit të pozitës dominuese të shoqërisë NOA CONTROL SHPK”,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrjet ALCERT SHPK, ECIT SHPK, SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK, ST2 SHPK dhe M.F.M SHPK, nëpërmjet shkresës nr. 539 prot. AK, datë 22.12.2021, kanë paraqitur një ankesë lidhur me pasojat në treg të krijimit të pozitës dominuese të shoqërisë NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.
2. Nga vlerësimi ligjor dhe administrimi i provave në kuadër të kësaj ankese rezulton se: Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 646, datë 09.08.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, ka dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ka vendosur: “*T’i kërkojë shoqërisë NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje e cila fiton të drejta të vecanta nëpërmjet Draf Kontratës së koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar*”.
3. Më datë 21.08.2019, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Autoriteti Kontraktues, Shoqërisë NOA CONTROL SHPK (Koncesionari) dhe shoqërisë NOA INSPECT SHPK (Shoqëria Koncesionare) është nënshkruar Kontrata e Koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”. Për realizimin

e kësaj Kontrate, Koncesionari NOA CONTROL SHPK ka themeluar Shoqërinë Koncesionare NOA INSPECT SHPK.

4. Nëpërmjet kësaj Kontrate Koncesioni, *Koncesionarit i është dhënë e drejta e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës koncesionare. Zona gjeografike e këtij koncesioni është gjithë territori i Republikës së Shqipërisë dhe periudha e koncesionit është 20 vjetë.*
5. Referuar nenit 14 të Kontratës së Koncesionit, tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose GLN do të jenë sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (ish Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 08.02.2013, “Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të drejtorisë së përgjithshme të metrologjisë”. Frekuenca e verifikimit të rregullt të instrumenteve matës do të jetë jo më pak se 2 (dy) herë në vit për çdo Subjekt.
6. Referuar nenit 14.3, palët mund të bien dakord për rritjen e frekuencës së verifikimit të rregullt të instrumenteve mates, *për një periudhë tranzitore*, në rast se: a) Gjatë kryerjes së verifikimeve në terren rezultojnë se mbi 5% e totalit të instrumenteve matës të verifikuara rezultojnë me probleme; dhe/ose, b) Databazat, të dhënat dhe fletët e punës që do të dorëzohen nga Autoriteti Kontraktues sipas dispozitave të kësaj kontrate, përmbajnë pasaktësi ose janë të paplota. Rritja e frekuencës mund të bëhet *për të gjithë subjektet e detyruara ose për zona ose subjekte të detyruara të caktuara.*
7. KK me Vendimin nr. 646/2019 i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rishikimin e pikës 3 të nenit 14 të draft kontratës koncesionare (sipas pikës II/2 të dispozitivit të VKK), pasi ka konstatuar se kjo pikë për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja NOA CONTROL SHPK kufizon konkurrencën (pika 23 e pjesës argumentuese të VKK nr. 646/2019). Në kontratën e miratuar ky rekomandim nuk është reflektuar.
8. Aktualisht kjo kontratë është në fazën e operimit. Shoqëria koncesionare ka realizuar 100% investimin në përputhje me grafikun e investimeve dhe specifikat teknike, investim i cili është verifikuar dhe miratuar edhe nga ana e Autoritetit Kontraktor. Kryerja e shërbimit në terren ka filluar më datë 31 Mars 2020, pas miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktues të investimeve të kryera¹.
9. Ndërmarrja NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje me të drejta të veçanta, ka detyrimin e zbatimit të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 gjatë ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
10. Kjo Ndërmarrje Koncesionare krahas shërbimit të verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN, si Organ i Miratuar nga MIE, ofron edhe shërbime të tjera për subjektet e shitjes me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, ndër të cilat: Inspektimin e depozitave të naftës e GLN-së; Çertifikimin e punonjësve/personave që përdorin pajisje nën presion, ku përfshihen edhe punonjësit që përdorin distributorët/pompat e GLN-së; si dhe Lëshimin e vërtetimeve teknike për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportit, tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre; shërbime këto të cilat ofrohen gjithashtu edhe nga subjekte të tjera konkurrense/Organe të Miratuara.
11. Referuar vlerësimit ligjor të draft kontratës dhe rekomandimeve të dhëna me VKK nr. 646/2019, rekomandime të cilat nuk reflektohen plotësisht në Kontratën e miratuar midis palëve, vihet re se të drejtat

¹ Referuar Raportit Vjetor të Përmbledhur të MFE, “Performanca e Kontratave të Koncesionit dhe Partneritetit Publik Privat”, viti 2020.

që i jepen Koncesionarit nëpërmjet nenit 14 të kontratës i krijojnë atij mundësinë për të abuzuar me pozitën dominuese që ajo ka fituar. Kjo fuqi që i jepet Koncesionarit NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, e vendos atë në pozita më të favorshme kundrejt ofruesve konkurrentë të shërbimeve të tjera që ajo ofron ndaj subjekteve të tregtimit të karburanteve, siç janë: shërbimi i inspektimit të depozitave të GLN-së, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve që përdorin pajisje nën presion.

12. Në këto kushte, ofruesit e tjerë të këtyre shërbimeve (Organet e Miratuara) pretendojnë se: *“... janë në pozita inferiore dhe krejtësisht të pafavorshme konkurrence, për shkak të pozitës dominuese të NOA CONTROL SHPK në ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së, të cilat i shërbejnë për të zgjeruar pozitën e saj dominuese në të gjithë gamën e mundshme të shërbimeve inspektuese që ajo ofron ndaj subjekteve të tregtimit të karburanteve”*.
13. Referuar pretendimit të ankuesve: “NOA CONTROL SHPK i është lënë gjithë hapësira e mundshme për të shfrytëzuar apo abuzuar me pozitën e saj dominuese në ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së, duke iu imponuar direkt apo indirekt subjekteve të tregtimit të karburanteve edhe në kryerjen e shërbimeve të tjera si paketë, përfshirë ato të inspektimit të depozitave të GLN-së, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve që përdorin pajisje nën presion”.
14. Kjo sjellje e ndërmarrjes koncesionare NOA CONTROL SHPK mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese që zotëron ky koncesionar në ofrimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me pasojë kufizimin e konkurrencës në tregjet e lidhura si ato të shërbimit të inspektimit të depozitave të GLN-së dhe karburanteve, lëshimit të Vërtetimit Teknik dhe çertifikimit të punonjësve që përdorin pajisje nën presion, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2019 deri në 31 Janar 2022.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 864, Datë 15.02.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË DAIMLER TRUCK AG, TRATON INTERNATIONAL S.A DHE VOLVO ENERGY AB”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.02.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët ndërmjet shoqërive Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB”, palët janë:

Pala 1: Daimler Truck AG [_____].

Daimler Truck AG nuk ka [_____].

Pala 2: Traton International S.A është një shoqëri aksionare, e krijuar sipas ligjeve të Luksemburgut dhe objekti i shoqërisë është pjesëmarrje në shoqëri vendase dhe të huaja, ose shoqëri të çfarëdo lloji dhe menaxhim i këtyre pjesëmarrjeve etj. Traton International S.A është një degë e zotëruar plotësisht nga Traton SE, [_____]. Traton SE është një filial i zotëruar indirekt nga Grupi Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij:

Porsche Leasing SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të

tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Pala 3: Volvo Energy AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Suedisë, e cila ofron automjete dhe makineri elektrike për një sërë aplikimesh. Volvo Energy AB është një degë e zotëruar indirekt nga Aktiebolaget Volvo, [_____].

Grupi Volvo nuk ka [_____].

Ndërmarrja e përbashkët (JV) do të themelohet si një [_____]. Ndërmarrja e Përbashkët do të përqendrohet [_____]. Ndërmarrja e përbashkët (JV), do të jetë [_____].

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët ndërmjet shoqërive Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB”, palët synojnë të [_____].

JV do të jetë një [_____].

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture) me funksione të plota nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e qendrave publike të karikimit me voltazh të lartë për kamionë të rëndë dhe autobusë me bateri elektrike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëritë Daimler Truck AG dhe Volvo Energy AB janë [_____], ndërkohë që shoqëria Traton International S.A është [_____].

J-V do të operojë në [_____].

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG, Traton International S.A dhe Volvo Energy AB.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 865, Datë 25.02.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ELPRO GROUP AG NGA SHOQËRIA ROBERT BOSCH INTERNATIONALE BETEILIGUNGEN AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Elpro Group AG nga shoqëria Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Elpro Group AG nga shoqëria Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Elpro Group AG nga shoqëria Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e blerjes së aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në përputhje me ligjet e Zvicrës, me objekt aktiviteti: blerja, administrimi dhe shitja e investimeve të të gjitha llojeve, veçanërisht e atyre në shoqëri tregtare dhe prodhuese, në kuptimin e një shoqërie holding.

Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG është shoqëria mëmë fundore e Grupit Bosch, një furnizues aktiv, në nivel global, i teknologjisë dhe shërbimeve për industrinë e automobilave, teknologjinë industriale, mallrat e konsumit dhe energjisë dhe industrinë e teknologjisë së ndërtimit.

Grupi Bosch nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura gjatë viti 2020.

Pala Shitëse:

Z. Beat Robert Rudolf ; Z. Martin Thomas Peter; Z. Josef Othmar Schmid, shtetas zviceran, të cilët së bashku zotërojnë 100% të aksioneve të shoqërisë target.

Target: Elpro Group AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në përputhje me ligjet e Zvicrës, me objekt aktiviteti; ofrimin e shërbimeve të plota që kanë të bëjnë me pajisjet monitoruese

teknologjike të zinxhirëve të furnizimit me temperaturë të kontrolluar në industrinë farmaceutike, kujdesin shëndetësor dhe shkencat e jetës.

Shoqëria zotërohet në 49.625% të kapitalit aksionar nga Z. Beat Robert Rudolf; 49.625% të kapitalit aksionar nga Z. Martin Thomas Peter dhe 0.75% të kapitalit aksionar nga Z. Josef Othmar Schmid.

Targeti nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura të pakta nga aktivitetet e shitjes gjatë vitit 2020.

Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG dhe shitësve është nënshkruar dokumenti “Marrëveshja e blerjes së aksioneve”. Sipas pjesës C të marrëveshjes, shitësit do të shesin të gjitha aksionet tek shoqëria blerëse Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG dhe pas përfundimit të transaksionit, blerësi Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG do të zotërojë 100% të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë Elpro Group AG.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Elpro Group AG nga shoqëria Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe palët plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, të ligjit, e si i tillë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për zgjidhjen e monitorimit të zinxhirit të ftohjes në industrinë farmaceutike, atë të kujdesit shëndetësor dhe shkencave të jetës dhe zgjidhjet e monitorimit të dhomave të pajisjeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Pala blerëse dhe targeti veprojnë në tregje të ndryshme duke i dhënë transaksionit karakteristikat e një përqendrimi konglomerat.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Elpro Group AG nga shoqëria Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 866, Datë 25.02.2022

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë.

Baza ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi projekt-vendimin “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë”,

VËREN SE:

1. Autoriteti i Konkurrencës, nisur nga disa shqetësime të raportuara nga media audio-vizive, për sa i përket një rritje të çmimit të karburantit të llojit naftë dhe benzinë, ka monitoruar me datë 03.02.2022 çmimin e karburantit naftë dhe benzinë, pranë ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e tregtimit me pakicë të karburanteve.
2. Nga deklaratat e marra gjatë monitorimit, u konstatua se në muajt e fundit ka patur një rritje periodike të vazhdueshme të çmimit të karburantit. Konstatohet se në situatën aktuale nafta tregtohet me rreth 190-192 lekë, ndërsa benzina deri në 194 lekë, në nivelet më të larta kombëtare.
3. Tregu i shitjes me shumicë përfshin ndërmarrjet importuese të karburantit të llojit naftë dhe benzinë, si dhe ato që e blejnë me shumicë në treg të brendshëm. Rritja e çmimit të naftës dhe të benzinës është reflektuar në të gjithë tregun e shitjes me pakicë dhe për pasojë duke rezultuar në çmime përgjithësisht më të larta për konsumatorin fundor.
4. Sa më lart, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë, mund të përbejë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë.
 - II. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore 1 janar 2021 deri në 25 shkurt 2022.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 867, Datë 04.03.2022

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR “MBI VEPRIMTARINË E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2021 DHE PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2022””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021 dhe prioritetet kryesore për vitin 2022.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Draft Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021 dhe prioritetet kryesore për vitin 2022”,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021 dhe prioritetet kryesore për vitin 2022”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

40. Miratimin e “Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021 dhe prioritetet kryesore për vitin 2022”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 868, Datë 04.03.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SCAN SHA NGA SHOQËRIA BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK,

VËREN SE:

Transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë SCAN SHA, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve, nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratës së shitblerjes të aksioneve”, palët në kontratë janë:

Pala Blerëse: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: investimin në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), ofrimin e shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me 100% të kuotave.

Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK nuk operon në tregun e mediave audiovizive.

Pala Shitëse:

Z. Adrian Pere zotërues i 4.66% të aksioneve të shoqërisë target; Z. Aleksandër Pilo zotërues i 11.66 %; Z. Arjan Hana zotërues i 11.30%; Z. Artan Xhori zotërues i 9.66%; Z. Astrit Hana zotërues i 31.94%; Z. Neritan Dojaka zotërues i 8.82%; Z. Renis Tërshana zotërues i 12.62% dhe Z. Thoma Minga zotërues i 9.32% të aksioneve të shoqërisë.

Target: SCAN SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari radiotelevizive dhe përgjithësisht çdo operacion financiar, tregtar, industrial me pasuri të paluajtshme, që mund të lidhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me ushtrimin e veprimtarisë radiotelevizive.

SCAN SHA e ushtron aktivitetin e saj në fushën radiotelevizive, referuar Licencës me nr. 113/2020 “Për shërbimin e programit audioviziv”, nëpërmjet kanalit televiziv SCAN dhe radios Alpet.

Shoqëria SCAN SHA nuk ka filiale në pronësi dhe nuk ka investime të kuotave në asnjë shoqëri tjetër.

Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe shitësve, Z. Adrian Pere, Z. Aleksandër Pilo, Z. Arjan Hana, Z. Artan Xhori, Z. Astrit Hana, Z. Neritan Dojaka, Z. Renis Tërshana, Z. Thoma Minga është nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje aksionesh”.

Referuar kësaj kontrate, shitësit marrin përsipër t’i shesin dhe t’i transferojnë blerësit Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, aksionet target, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë SCAN SHA. Ky kalim, do të kryhet në datën e finalizimit të transaksionit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

Realizimi i këtij transaksioni do të ndodhë pasi të plotësohen kushtet e parashikuara në kontratë, ku përfshihet: përmbushja e detyrimeve ndaj të tretëve (furnitorëve); miratimi i Bankës Credins për transferimin e pronësisë së aksioneve, në përputhje me kontratat e financimit të lidhura ndërmjet Bankës Credins dhe shoqërisë SCAN SHA, dhe miratimi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përputhje me pikën 6 të nenit 55 të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, dhe plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i medias audiovizive. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti i Media Audiovizive (AMA), në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kontrollon zbatimin e ligjit për median dhe licencon subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive.

Në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, janë të përcaktuara dhe të rregulluara të gjitha aspektet që lidhen me pronësinë dhe bashkëpronësinë në transmetimet audio dhe audiovizive.

Në lidhje me transaksionin e njoftuar, pala blerëse ka kërkuar miratimin e AMA-s për ndryshimin e pronësisë së shoqërisë SCAN SHA, e cila nëpërmjet shkresës nr. 348/1, datë 28.01.2022 “Kthim përgjigje tuajës”, duke ju referuar nenit 62 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon rastet e kufizimeve të pronësisë për zotërimin e kuotave/ aksioneve në subjekte audio dhe audiovizive, ka konstatuar se, duke qenë se shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK nuk zotëron kuota/aksione në subjekte të tjera audio/audiovizive, zotërimi i aksioneve në shoqërinë SCAN SHA nuk bie ndesh me kufizimet e kësaj dispozite ligjore.

Sipas shërbimeve të ofruara, OSHMA-të (Subjekte Audio dhe Audiovizive), ndahen në katër grupime të mëdha (i) televizionet, (ii) radiot, (iii) kabllorët dhe (iiii) shërbimet e tjera.

Referuar licencës së shoqërisë SCAN SHA, kjo shoqëri është aktive në shërbimet audiovizive (televizion).

Sipas statistikave të AMA për vitin 2019 konstatohet se, sipas treguesit të ardhurave të realizuara, shoqëria SCAN SHA renditet e teta, sipas nivelit të aseteve fikse shoqëria SCAN SHA renditet e katërta, ndërsa sipas treguesve të rezultatit ekonomik (fitimit) të vitit 2019, shoqëria SCAN SHA nuk është pjesë e dhjetë OSHMA me rezultatin ekonomik më të lartë gjatë vitit 2019.

Nga treguesit e mësipërm konstatohet se shoqëria SCAN ka investuar ndjeshëm në vlerën e aseteve fikse, ka një nivel të kënaqshëm të të ardhurave të realizuar nga aktiviteti ekonomik, por nuk renditet në kompanitë më të mira për treguesin e vlerës së fitimit, tregues i eficensës ekonomike të shoqërisë.

Sipas statistikave të AMA-s nuk konstatohen të dhëna statistikore për radio Alpet, duke mos u klasifikuar në 10 radiot me të mira në transmetimet audio.

Transaksioni i njoftuar do të synojë përfitim të kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria Balfin Finance Investment Group SHPK, e cila nuk operon në tregun e mediave audiovizive.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun horizontal ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim të pjesës së tregut të shoqërisë target, në tregun e mediave audiovizive në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria Balfin Finance Investment Group SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 869, Datë 08.03.2022

“MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA TELECOM INVEST AD NGA SHOQËRIA 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji), nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimet: “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve”; “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”; “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”; “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”; “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe “Formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi rastin e përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve, të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag,

VËREN SE:

I. Procedura

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës (këtu e në vijim AK ose Autoriteti) është njoftuar transaksioni, i cili konsiston me blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.
2. Njoftimi i përqendrimit është depozituar brenda afatit 30 ditë nga lidhja e marrëveshjes së përfimit të kontrollit, e parashikuar në nenin 12, pika 2, të ligjit.
3. Në zbatim të nenit 64 të ligjit, në datë 27.01.2022, Autoritetit të Konkurrencës, në faqen zyrtare elektronike ka njoftuar fillimin e procedurave të vlerësimit të transaksionit dhe ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionin e tyre mbi transaksionin njoftuar.
4. Në mbështetje të nenit 70, pika 3 e ligjit, Autoriteti ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në lidhje me transaksionin e njoftuar, në përgjigje të së cilës AKEP ka depozituar shkresën nr. 73/4 datë 27.01.2022 (protokolluar me tonën nr. 60/9 datë 31.01.2022) “Përcillet vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, sa i përket njoftimit zyrtar të sipërmarrësit One Telecommunications SHA, për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare”.

5. Nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 27.01.2022 “Mbi njoftimin zyrtar të sipërmarrësit One Telecommunications SHA për ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë tregtare”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi: Të miratojë qëndrimin e AKEP lidhur me njoftimin zyrtar të sipërmarrësit “One Telecommunications” SHA.
6. Në zbatim të nenit 55 të ligjit dhe rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Autoriteti i ka kërkuar përfaqësuesit ligjor të palës njoftuese, plotësimin e formularit të plotë të njoftimit të përqendrimit, i cili është depozituar me shkresën nr. 60/13 prot., i AK datë 07.02.2022 “Konfirmim i depozitimit të dokumenteve”.
7. Mbështetur mbi relacionin të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi vlerësimin paraprak të njoftimit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD (ATI AD) nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt), Komisioni i Konkurrencës konstatoi se transaksioni i propozuar pritet të sjellë bashkim mes dy operatorëve në tregun celular (One Telecommunications dhe Albtelecom), duke reduktuar numrin e operatorëve celularë në 2, (Vodafone dhe operatori i bashkuar). Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, i cili mund të krijojë pozitë dominuese të palëve në marrëveshje dhe mund të sjellë mbivendosje të aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar.
8. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 861, datë 31.01.2022, vendosi fillimin e procedurës së thelluar për vlerësimin e transaksionit që synon përfitim të kontrollit të shoqërisë ATI AD nga shoqëria 4iG Nyrt.
9. Në datë 31.01.2022, në zbatim të nenit 64 të ligjit, është publikuar njoftimi mbi fillimin e procedurës së thelluar për vlerësimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ATI AD nga shoqëria 4iG Nyrt, si dhe vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 861 datë 31.01.2022 “Për fillimin e Procedurës së Thelluar për vlerësimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag”.
10. Me qëllim realizimin e një analize të plotë mbi tregun dhe pasojat që do të sjellë përfitimi i kontrollit të shoqërisë ATI AD nga shoqëria 4iG Nyrt në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, mbështetur të nenit 34 dhe 70, pika 3 e ligjit, Autoriteti me shkresën nr. 60/12 prot., datë 03.02.2022 “Kërkesë për informacion”, kërkoj bashkëpunimin e AKEP për sigurimin e informacionit të nevojshëm, i cili u depozitua nga AKEP me shkresën nr.187/1 prot., datë 14.02.2022 “Mbi tuajën nr. 60/12 datë 03.02.2022 “Kërkesë për informacion”. Nëpërmjet shkresës AKEP shprehet “*se nuk jemi përpara faktit të transferimit të Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave pasi as nga sipërmarrësi One Telecommunications SHA dhe as nga sipërmarrësi Albtelecom SHA nuk është kërkuar bashkimi i dy shoqërive, por bëhet me dije vetëm ndryshimi i strukturës aksionare të secilës prej shoqërive..., të cilat nuk ndikojnë në detyrimet e sipërmarrësve kundrejt organit rregullator*”.
11. Gjithashtu, në zbatim të nenit 39 të ligjit, Komisioni i Konkurrencës me shkresën nr. 60/14 prot., i AK, datë 07.02.2022 dhe shkresën nr. 60/15 prot., i AK, datë 11.02.2022 “Ftesë për seancë dëgjimore”, ftoi përfaqësuesin ligjor të shoqërisë 4iG Nyrt dhe shoqërinë Vodafone Albania SHA, për tu dëgjuar në lidhje me këto zhvillime në tregun e komunikimeve elektronike.
12. Në datë 16 shkurt 2022, u organizua seanca me z. Péter Fekete, zëvendës CEO i shoqërisë 4iG Nyrt, z. Pal Zarandy këshilltar i jashtëm ligjor (kryesisht për çështjet e marrëveshjeve të përfimit të kontrollit) dhe përfaqësues të studios ligjore të pajisur me autorizim përfaqësimi pranë Autoritetit të Konkurrencës.
13. Përfaqësuesit e shoqërisë prezantuan objektivat dhe strategjinë e shoqërisë 4iG Nyrt në fushën e teknologjisë së informacionit, duke u fokusuar në industrinë e sistemeve të integruara të teknologjisë informatike, ngritjen e infrastrukturës së telekomunikacionit, zhvillimin e sistemeve të sigurisë kibernetike dhe zgjerimin në industrinë e hapësirës dhe telekomunikacionin nëpërmjet kësaj teknologjie. Në kuadër të

strategjisë së zgjerimit, shoqëria 4iG, sapo ka mbyllur marrëveshjen e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telenor, Monte Negro, ofrues i shërbimit të telefonisë celulare në Malin e Zi dhe e vlerëson tregun e telekomunikacionit në Shqipëri si një treg me kërkesë në rritje dhe mundësi investimi.

14. Shoqëria 4iG Nyrst synon që, nëpërmjet përfutimit të kontrollit edhe të operatorit One Telecommunications (pas marrjes së kontrollit të shoqërisë Albtelecom SHA), do të ketë mundësinë të mëdha menaxhimi dhe investimi, duke eliminuar teprica të konsiderueshme të krijuara nga mbivendosja e infrastrukturës si dhe duke harmonizuar shpenzimeve operacionale dhe investimet në kapital. Kombinimi i dy infrastrukturave do mundësojë implementimin e një platformë "rrjeti 5G", me qëllim krijimin e rrjetit më të mirë dhe më të fuqishëm kryesues 5G, jo vetëm brenda grupit të ri rajonal të 4iG (Mal i Zi dhe Shqipëri) por edhe në të gjithë Ballkanin. Shoqëria synon zëvendësimin e teknologjisë Huawei të përdorur nga operatori Albtelecom me rrjetet Clean Network, iniciativë e ndërmarrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe e përkrahur nga Qeveria Shqiptare, për sigurimin e rrjeteve të sigurta në terma afatgjatë
15. Komisioni i Konkurrencës, në datë 25 shkurt 2022 organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë Vodafone Albania SHA.
16. Përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë Vodafone Albania SHA, në fjalën e tyre përpara Komisionit të Konkurrencës dhe në materialin e dërguar paraqitën si vijon:
 - Në parim Vodafone Albania, rishpreh qëndrimin që ka mbajtur në mënyrë konsistente se madhësia modeste e tregut shqiptar të telekomunikacionit e shoqëruar nga zhvillimi dinamik i tij veçanërisht në telefoninë e lëvizshme si pasojë e investimeve të kushtueshme teknologjike, konkurrencës së lartë me marzhe fitimi gjithnjë e më të ulta, e bëjnë konsolidimin e tregut një zhvillim organik dhe të natyrshëm. Në nivel historik tregu i telekomunikacionit në Shqipëri ka evoluar nga 4 në 3 operatorë në vitin 2017, me daljen e operatorit Plus pas 7 vitesh me performancë të dobët dhe nga 3 në 2 operatorë në vitin 2022, me blerjen e Albtelecom dhe One prej kompanisë 4iG.
 - Ndërkaq, operatori Albtelekom (incumbent-i), i treti aktualisht në treg, pavarësisht avantazhit historik absolut konkurrues në: i) mundësinë për të ofruar paketa të konverguara për shërbime mobile dhe shërbime fikse dhe ii) dominancës në tregun duopol me shumicë, ka më se një dekadë që performon dobët. Kjo dëshmohej jo vetëm nga efica e ulët në treg, por dhe në të gjitha vështirësitë financiare që ky operator ka dëshmuar të ketë prej disa vitesh në shlyerjen e detyrimeve.
 - Për më tepër, zhvillimet e pritshme në treg si 5G do të kërkojnë investime të konsiderueshme të nevojshme për t'i transformuar rrjetet dhe sistemet në këtë teknologji (5G), me performancë të lartë, të cilat do të mbështesin fuqishëm ekonominë digjitale të Shqipërisë në vitet e ardhshme
 - Nga ana tjetër ne besojmë se tregu mobile është mjaft konkurrues sot, me çmime shumë të përballueshme (më të ulëta në krahasim me vendet e BE-së), me shërbime me cilësi të lartë, me rrjet të shkëlqyer, me shumëllojshmëri produktesh me parapagesë, hibride, si dhe me pagesë të përshtatur për secilin segment të klientit.
 - Ky përqendrim, që vjen nga bashkimi mes operatorit aktual Albtelecom (operatori FNT) në tregun me shumicë dhe lojtarit të dytë në telefoninë mobile One me një diferencë të ngushtë të pjesëve takuese të tregut me Vodafone, e bën këtë transaksion:
 - Të pashembullt me transaksionet e mëparshme dhe impaktin në tregjet me shumicë dhe pakicë (p.sh. blerja e Abcom e cila pavarësisht impaktit të ulët në tregje ishte subjekt i një monitorimi dy-vjeçar nga Autoriteti i Konkurrencës dhe i një sërë detyrimeve rregulluese/remedies nga ky i fundit).
 - Sjell nevojën për ta analizuar nën prizmin e krijimit të mundshëm të tregjeve monopolistike në tregun me shumicë dhe të PayTV, në rast të blerjeve të mundshme të operatorit tjetër në fushën e tregut duopol me shumicë të telekomunikacionit (si psh ATU-së) ose Digitalb.

- Objekt të domosdoshëm rregullimi nëpërmjet masave rregullatore/remedies që do të sigurojnë ruajtjen e konkurrencës së ndershme në treg.
 - Në këtë këndvështrim Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Infrastrukturës & Telekomunikacionit dhe AKEP, duhet të kenë një pasqyrë të qartë se çfarë pasojash do të sjellë ky transaksion për konsumatorët, operatorët, shtetin dhe tregun në përgjithësi. Vodafone Albania gjykon se një treg i shëndetshëm dhe konkurrues mund të funksionojë plotësisht edhe me 2 operatorë nëse AKEP dhe AK do të trajtojnë me kujdesin e duhur problemet e konkurrencës nëpërmjet masave rregullatore të nevojshme.
 - Së fundi, për çfarë është më e rëndësishme, Autoriteti i Konkurrencës duhet të vlerësojë me kujdes tërësinë e masave rregullatore dhe mjeteve juridike që ka në dispozicion për të rregulluar tregun duke mbajtur parasysh që ato të jenë proporcionale me situatën që synojnë të balancojnë, dhe të rregullojnë shkallën e përqendrimit dhe natyrën e dëmit, i cili potencialisht mund të sjellë shtrembërim të konkurrencës, diskriminim të lojtarëve të tjerë në treg, duke dëmtuar klientët, bizneset dhe vetë tregun. Dëmet që mund t'i vijnë tregut duhet të evidentohen në detaje përpara miratimit të përqendrimit të tregut. Mjetet juridike (masat rregullatore) duhet të fokusohen në ato aspekte që janë thelbësore për funksionimin e industrisë së telekomunikacionit.
17. Në lidhje me sa më sipër, përfaqësuesit e shoqërisë Vodafone Albania SHA, gjykojnë se autorizimi i përqendrimit duhet të jepet me kushte dhe detyrime si nga Autoriteti i Konkurrencës ashtu edhe nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
18. Të dyja shoqëritë e ftuara në seancë u shprehen për të bashkëpunuar me rregullatorët për vlerësimin dhe ruajtjen e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike.

I. Palët në marrëveshje. Përqendrimi

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

19. Shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.
20. Shoqëria 4iG Nyrt zotërohet nga KZF Vagyonkezelő Ltd. & MANHATTAN Magántőkealap 56.85 %; Alpac Capital 5.05%; Aksione të veta 0.83%, Aksione të punonjësve 3.88 % dhe Aksione të lira (Free float) 33.39%. Shoqëria KZF Vagyonkezelő Kft, aksionari më i madh i 4iG-së, zotërohet 100% nga Z. Jászai Gellért Zoltán, president dhe CEO i 4iG Nyrt.
21. Shoqëria 4iG Nyrt zotëron paketën kontrolluese në 14 shoqëri të tjera në Hungari, ku me interes për transaksionin në Shqipëri është filiali i saj, shoqëria Invitech ICT Services Limited Liability, një nga ofruesit kryesorë në Hungari në fushën e shërbimeve të infrastrukturës së rrjetit të telekomunikacionit dhe IT. Blerja e Invitech ishte një hap i rëndësishëm në ndërtimin e zgjidhjeve end-to-end për 4iG, me të cilat, përveç telekomunikacionit, grupi i 4iG është në gjendje të zgjerojë shërbimet e tij në fushat që lidhen me teknologjinë e informacionit (p.sh. cloud, qendra e të dhënave, IoT).
22. Në janar 2022, shoqëria 4iG Nyrt njofton synimin e arritjes së një marrëveshje strategjike me shoqërinë gjermane Rheinmetall AG, një nga grupet lider në fushën e mbrojtjes në Evropë, nëpërmjet të cilës, shoqëria Rheinmetall AG do të blejë një pjesë të aksioneve të KZF Vagyonkezelő Ltd si dhe do të investojë

nëpërmjet rritjes së kapitalit të shoqërisë 4iG Nyr. Pas mbylljes së kësaj marrëveshjeje, struktura aksionare e shoqërisë 4iG Nyr do të ndryshojë.

23. Gjatë viteve të fundit, 4iG Nyr ka realizuar disa marrëveshje me operatorë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit në Hungari dhe sapo ka mbyllur marrëveshjen e përfundimit të kontrollit mbi shoqërinë TELENOR MONTENEGRO, një nga operatorët e rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Malin e Zi. Bashkë me përfundimin e kontrollit mbi Albtelecom SHA, blerësi synon zgjerimin në vendet e Ballkanit Juglindor.
24. 4iG Nyr ka hyrë në tregun e telekomunikacionit të Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjes së përfundimit të kontrollit të 80.27% të kuotave të shoqërisë Albtelecom SHA.

Pala shitëse:

25. *Shitësi 1:* ATI Albanian Telecom Invest LTD, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Qipros, me përfitues fundor Z. Spas Roussev, e cila është krijuar me qëllim për të krijuar e vetme ose në bashkëpunim me të tjerë në çdo vend të botës biznesin e një shoqërie investimesh, etj.
26. *Shitësi 2:* Adarna Eood, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm Z. Atanas Iliev Dobrev, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.
27. *Shitësi 3:* Guri Enterprises B.V, e cila është një shoqëri me formë ligjore të krahasueshme me një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Hollandës. Guri Enterprises B.V, është një shoqëri financiare holding.
28. *Shitësi 4:* River Styxx Capital EAD, është një shoqëri aksionare me ortak të vetëm Z. Elvin Guri, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.

Shoqëria Target:

29. Shoqëria Albania Telecom Invest AD (ATI), është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: investime dhe aktivitete në fushën e telekomunikacioneve si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohet nga legjislacioni i Republikës së Bullgarisë.
30. Shoqëria Albania Telecom Invest AD zotërohet nga shoqëritë: Albanian Telecom Invest LTD me 19.9% të kapitalit; Adarna Eood me 25.96% të kapitalit; Guri Enterprises B.V me 45% të kapitalit dhe River Styxx Capital EAD me 9.14% të kapitalit (palët shitëse në marrëveshje).
31. Shoqëria Albanian Telecom Invest AD, është zotëuese e 99.899% të aksioneve të shoqërisë One Telecommunications SHA, transaksioni i cili u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 610, Datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”.

Filiali:

32. Shoqëria One Telecommunications SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM, të ofrojë shërbimin e roamingut ndërkombëtar, etj.
33. Shoqëria zotërohet në 99.899% të aksioneve nga Albania Telecom Invest AD dhe pjesa e mbetur zotërohet nga 5 aksionerë të ndarë në përqindje pjesëmarrje, nën 0.03% të aksioneve.

II. Përqendrimi

34. Ndërmjet, shoqërisë 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag dhe shitësve ATI Albanian Telecom Invest LTD, Adarna Eood, Guri Enterprises B.V dhe River Styxx Capital EAD është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh” në lidhje me shitblerjen 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Albania Telecom Invest AD, datë 23 dhjetor 2021.
35. Referuar kësaj Marrëveshje, shitësit zotërojnë në total sasinë prej 50.000 aksione (që përfaqësojnë 100% të të gjithë aksioneve) në kapitalin e shoqërisë Albania Telecom Invest AD.
36. Përfundimi i transaksionit do të kushtëzohet me plotësimin e kushteve të konkurrencës (autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës), plotësimin e kushtit të pëlqimit nga AKEP, plotësimin e kushtit të pëlqimit nga OTP.
37. Shoqëria Albania Telecom Invest AD, zotëron 812,997 aksione (që përfaqësojnë 99.899% të të gjitha aksioneve) në kapitalin aksionar të shoqërisë One Telecommunications SHA.
38. Në përfundim të transaksionit, shoqëria 4iG Nyrt do të fitojë kontrollin e drejtpërdrejtë, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD, dhe kontrollin jo të drejtpërdrejtë, mbi shoqërinë One Telecommunications SHA, i cili përbën një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Analiza e Konkurrencës

39. Tregu i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është një treg i mbikëqyrur nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), veprimtaria e të cilit mbështetet në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nënligjore dhe rregullatore të nxjerrë në zbatim të ligjit.
40. Qëllimi i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kryerjen e veprimtarisë së tij, AKEP ndiqet nga parimet:
- Përdorimit sa më efikas të spektrit të frekuencave nga operatorët celularë në Shqipëri;
 - Respektim të parimit të paanshmërisë (neutralitetit) teknologjik;
 - Nxitjen e investimeve eficiente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre.
 - Nxitjen e konkurrencës eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera.
 - Mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.
 - Mbrojtjen e interesave të sigurisë publike.
 - Mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike.
41. Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9918/2008 dhe nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003, AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar.

IV.1 Përcaktimi i tregut përkatës

43. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, “*tregu përkatës përbëhet*

nga produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese". Në zbatim të ligjit, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

44. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg. Në rastet e përqendrimeve përcaktimi i tregut është i dobishëm me qëllim që të identifikojë mbivendosjet dhe të vlerësojë efektet e transaksionit.
45. Sipas raportit të Komisionit Evropian mbi përcaktimin e tregut, tregu i komunikimeve elektronike, përfshin tregjet me shumicë dhe pakicë, ku tregjet me shumicë përfshijnë shërbimet e rrjetit të siguruara për ofruesit e shërbimeve, ndërsa tregjet me pakicë përfshijnë shërbimet që synojnë përdoruesit përfundimtarë (konsumatorët). Shkalla në të cilën këto tregjet duhet të dallohen për qëllime të politikës së konkurrencës varet nga shkalla e zëvendësueshmërisë midis tyre. Tregjet me shumicë dhe pakicë të komunikimeve elektronike nuk janë të zëvendësueshëm ndërmjet tyre nga ana e kërkesës, pasi këto dy lloje shërbimesh synojnë grupe të ndryshme përdoruesish.
46. Tregjet me shumicë dhe pakicë të komunikimeve elektronike janë të integruar vertikalisht me njëri-tjetrin, duke qenë se shërbimet me shumicë dhe shërbimet e terminimit të thirrjeve janë input kryesor për ofrimin e shërbimeve me pakicë (kombinimet e paketave, paketat në nivel pakice si për abonentët me parapagesë, dhe për abonentët të cilët paguajnë pas marrjes së shërbimit).
47. Ofruesit e komunikimeve elektronike (fikse dhe celulare) veprojnë njëkohësisht në të dy nivelet e tregut, si në rrjedhën e sipërme (tregu me shumicë), ashtu dhe në rrjedhën e poshtme të tij (tregu me pakicë).
48. Në tregun me pakicë, zëvendësueshmëria e dy shërbimeve (rrjeteve fikse dhe të lëvizshme) ka qenë objekt vlerësimi nga Komisioni i Konkurrencës¹ dhe AKEP të cilët i kanë vlerësuar si tregje të ndara shërbimet nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre të lëvizshme (celulare).
49. Në mënyrë të ngjashme, në Analizën e Tregut të Shërbimeve Celulare të vitit 2019, AKEP ka analizuar tregun e shërbimeve celulare si një treg të veçantë nga ai i telefonisë fikse.
50. Komisioni Evropian në rastin CASE M.7421- ORANGE / JAZZTEL/ 2015, në Spanjë, tregoi se (i) shërbimi celular i të dhënave nuk ofron të njëjtat karakteristika (p.sh. për nga kapaciteti apo modeli e çmimeve), dhe (ii) të dhënat e shërbimeve fikse dhe celulare synojnë nevojat të ndryshme të klientit (si p.sh. akses në internet në lëvizje, akses në aplikacione në telefoninë celulare).
51. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh në rastet kur një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai produkt dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese. Për shkak të veçorive të ndryshme që telefonia fikse ka në raport me telefoninë e lëvizshme, nga pikëpamja e konsumatorëve, shërbimet e telefonisë së lëvizshme nuk janë të zëvendësueshme me shërbimet e telefonisë fikse.
52. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës nënkupton që kompanitë të jenë të afta të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe t'i tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto shtesë, në përgjigje të ndryshimeve të vogla ose të përhershme të çmimeve. Për vetë veçoritë që kanë tregjet e veçanta të komunikimeve elektronike të shumicës dhe pakicës në rrjetet e lëvizshme apo fikse, për shkak të karakteristikave dhe infrastrukturës së nevojshme, nuk janë të zëvendësueshme nga ana e ofertës.

¹ Në vendimin nr. 303, datë 16.01.2014, Komisioni i Konkurrencës ka parashtruar se telefonia fikse nuk është përfshirë në tregun përkatës të shërbimit celular me pakicë për shkak të karakteristikave të ndryshme që ka kur krahasohet me telefoninë celulare. Nga këndvështrimi i një konsumatori këto shërbime nuk mund të zëvendësohen me shërbime të telefonisë celulare

53. Për sa më sipër, si dhe referuar tregjeve të shërbimeve të dy shoqërive, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme dhe në rrjetet e telefonisë fikse. Për analizimin e këtij rasti, *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë

IV.2 Vlerësimi i strukturave të tregut

54. Mbështetur në përcaktimin e tregut përkatës të produktit si dhe në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 131 datë 07.12.2009, janë vlerësuar pjesët e tregut të ndërmarrjeve në tregun përkatës të produktit, indekset e përqendrimit të tregut dhe ndryshimi i strukturës së tregut pas përqendrimit për shkak të mbivendosjes së pjesëve të tregut të palëve në transaksion.

55. Referuar të dhënave të AKEP të pasqyruara në raportet periodike si dhe informacionin e depozituar në AK me shkresën nr. 60/17 prot., i AK datë 17.02.2022, u konstatua se, në terma të të ardhurave të realizuara nga operatorët në tregun e komunikimeve elektronike (fikse dhe celulare) rezultoi se:

- Gjatë vitit 2020, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë raportuar rreth 33,45 miliardë lekë të ardhura nga komunikimet elektronike, ku pjesën më të madhe e realizojnë të ardhurat nga shërbimet e telefonisë celulare, me rreth 23.9 miliard lekë.
- Operatori me pjesën më të madhe të të ardhurave është operatori Vodafone, me rreth 38% të totalit të të ardhurave; i ndjekur nga One Telecommunications, me rreth 24%; Albtelecom, me rreth 21% të tregut dhe pjesa tjetër, rreth 17%, u takon operatorëve të tjerë të rrjeteve fikse.

IV.2.1 Tregu i terminimit të thirrjeve me shumicë

56. Sikurse është trajtuar edhe nga AKEP, shërbimi i terminimit të thirrjeve lejon përdoruesit e rrjeteve të ndryshme të komunikojnë me njëri-tjetrin. Terminimi i thirrjeve është një shërbim me shumicë i ofruar nga operatorë të ndryshëm të rrjetit ndaj njëri-tjetrit në bazë të marrëveshjeve të interkoneksionit.

57. Ky shërbim ndodh në rrjedhën e sipërme (upstream) të ofrimit të shërbimeve zanore përmes telefonisë celulare ose fikse. Terminimi mund të ndërthurë shërbimin fiks me shërbimin celular në rrjedhën e sipërme e anasjelltas.

58. Në përputhje me vendimet e Komisionit Evropian dhe AKEP², çdo operator celular apo fiks në tregun e terminimit zotëron 100% të rrjetit të tij individual, pasi nuk ka zëvendësues për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet individual. Në këtë kontekst, operatori One Telecommunications, sikurse dhe çdo operator tjetër, ka 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij të telefonisë celulare si dhe 100% pjesë tregu për thirrjet që terminojnë në rrjetin e tij fiks.

IV.2.2 Tregu i shërbimeve telefonike me pakicë

59. Sikurse u përcaktua në analizën e tregut përkatës të produktit, tregu i telefonisë celulare dhe tregu i telefonisë fikse janë të pazëvendësueshëm me njëri tjetrin dhe si të tillë dy tregjet, në nivelin e pakicës, do të analizohen të veçuar.

² Në Vendimin nr. 24, datë 30.03.2018 të AKEP për “Përcaktimin e ndërmarrjeve si FNT (me Fuqi të Ndjeshme në Treg) për shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin individual për publikun të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”, operatorët e telefonisë fikse janë përcaktuar me status FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve ndaj abonentëve të tyre në rrjetet e tyre fikse dhe tarifat e shërbimeve të terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin publik telefonik fiks janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me nr. 9, datë 17.7.2009, “Për Analizën e tregut”. Ky treg ka qenë gjithashtu pjesë e tregjeve për rregullim, sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014.

IV.2.2.1 Tregu i telefonisë celulare.

60. Shërbimet e komunikimeve elektronike të lëvizshme për klientët fundorë, ose ndryshe "shërbime celulare me pakicë" përfshijnë thirrje me zë, SMS (përfshirë MMS dhe mesazhe të tjera), akses në internet përmes rrjetit celular si dhe shërbime ndërkombëtare roaming me pakicë. Këto shërbime ofrohen në rrjetet 2G / GSM, 3G / UMTS dhe 4G / LTE, duke patur parasysh se rrjeti 3G është i përshtatur më mirë për sasi më të mëdha të të dhënave dhe shpejtësi më të shpejtë të downloadimit. 4G/LTE është një teknologji e lëvizshme që rrit shpejtësinë dhe kapacitetin e rrjetit dhe është përshtatur për përmirësimin e cilësisë së zërit dhe transmetimit të të dhënave me shpejtësi të lartë nga pajisjet wireless. Aktualisht Shqipëria është bërë pjesë e iniciativës së ndërmarrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit për sigurimin e rrjeteve të sigurta, Clean Network, në terma afatgjatë.
61. Tregu i telefonisë celulare është një treg i rregulluar, me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave dhe referuar Kapitullit VI "Rregullimi i Konkurrencës" të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", vlerësimi i sjelljes së sipërmarrësve në treg është objekt i këtij ligji, i përcaktuar në nenet 31 deri 41 të tij.
62. Ofrimi i shërbimit realizohet nëpërmjet përdorimit të spektrit të frekuencave, të cilat aktualisht janë të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit", nga ku rezultoi se në brezin 800MHz FDD dhe 2600MHz TDD, AKEP ka të pa alokuar një pjesë të brezit të frekuencës. Vetëm shoqëria Vodafone Albania SHA zotëron një pjesë të brezit 2600MHz TDD, brez i spektrit të shpejtësisë së lartë.
63. Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë One Telecommunications nga 4iG Nyrt do të sjellë për pasojë edhe bashkimin e volumnit të spektrit sipas bandave respektive, duke i mundësuar dy shoqërive (One Telecommunications dhe Altelecom) të ketë në përdorim rreth 59% të spektrit të frekuencave, ndërkohë që shoqëria Vodafone Albania SHA do të zotërojë rreth 41% të tij.
64. Tregu i komunikimeve celulare, ka qenë në vite objekt vlerësimi dhe analize e Autoritetit të Konkurrencës, i cili në bashkëpunim me AKEP ka vlerësuar dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me shqetësimet e tregut.
65. Me daljen nga tregu të Plus Communication nga data 1.01.2018, tregu ka përjetuar një ndryshim të rëndësishëm strukturor duke e ndryshuar strukturën e tregut nga 4 (katër) në 3 (tre) operatorë, Telekom Albania (sot One Telecommunications), Altelecom dhe Vodafone Albania. Vlerësohet se largimi i operatorit Plus Communication nga tregu nuk ndikoi në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"
66. Nga analiza e treguesve sasiorë për shërbimet e ofruar nga operatorët celularë, u konstatua se:
- Tregu i shërbimeve celulare me pakicë ka karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar, ku indeksi i përqendrimit Hershman Herfindal (HHI) është mbi 3700.
 - Operatori Vodafone ka zotëruar gjatë të katër viteve dhe në të gjitha shërbimet më shumë se 45% të tregut. Në shërbimin e: -volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetin celular; - thirrjeve telefonike dalëse drejt rrjeteve fikse dhe celulare; - numrit të mesazheve SMS të dërguara përdoruesit dhe - përdoruesve aktive të aksesit broadband celular dhe telefonisë celulare, operatori Vodafone zotëron mbi 50% të tregut.
 - Operatori i dytë renditet One Telecommunications, i cili reflekton tendenca të rritje të pjesës së tregut në vitet 2020-2021.
 - Operatori Altelecom paraqet një rënie të konsiderueshme të pjesës së tregut sipas volumnit të të dhënave të transmetuara në rrjetin celular (në GB), për shkak të shfrytëzimit të ulët të rrjetit 4G/LTE. Ky operator ka shërbim të plotë vetëm në rrjetet 2G dhe 3G.
68. Përfutimi i kontrollit jo të drejtpërdrejtë të shoqërisë One Telecommunications nga 4iG Nyrt, do të ketë si pasojë përfutimin e kontrollit të dy operatorëve One Telecommunications dhe Altelecom nga e njëjta

shoqëri, **duke sjellë efektet e një përqendrimi horizontal, pasi transaksionet do të krijojnë mbivendosje të pjesëve të tregut të operatorëve One Telecommunications dhe Albtelecom në tregun e shërbimeve celulare me pakicë.**

69. Pjesa e kombinuar e tregut të dy operatoreve (One dhe Albtelecom) në vitin 2021 rezulton të jetë nga 42% deri në 55%, ku dy shoqëritë do të zotërojnë së bashku më shumë se gjysmën e tregut sipas treguesit të: përdoruesve aktive shërbimeve celulare; përdoruesve aktive të aksesit broadband celular dhe volumit të thirrjeve telefonike dalëse drejt rrjeteve fikse dhe celulare. Tregu i shërbimeve të telefonisë celulare me pakicë do të ketë karakteristikat e një tregu duopol, në të cilin do të operojnë dy konkurrentë me pjesë pothuajse të barabartë të tregut, sipas shërbimeve të ofruara.
70. Në pikën 10 të Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, përcaktohet se “Pjesët e mëdha të tregut, 50% e më tepër, në vetvete përbëjnë një evidencë të ekzistencës së një pozicioni dominante në treg” dhe, referuar pjesëve të tregut, konstatohet se operatori Vodafone dhe operatorët e bashkuar (One dhe Albtelecom) zotërojnë pozitë dominuese në treg.
71. Referuar nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003, pozita dominuese e ndërmarrjeve në treg përcaktohet, përveçse nga pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim edhe nga vlerësimi i:
- **Pengesave në hyrje** në tregun përkatës; nga ku vlerësohet se për shkak të mundësisë së kufizuar të të drejtës së përdorimit të spektrit të frekuencave por edhe nivelit të lartë të investimeve fillestare, tregu i shërbimeve celulare paraqet pengesa në hyrje për hyrës të rinj dhe për pasojë konkurrenca potenciale pothuajse nuk ekziston. Tregu i shërbimit të telefonisë celulare është prekur nga reduktim i numrit të operatorëve nga 4 në 3 dhe nuk ka patur hyrje të reja.
 - **Zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve** dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve. Shërbimi në tregun e komunikimeve elektronike ofrohet nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës fikse me kablllo optike dhe bakri ose nëpërmjet, antenave të transmetimit të sinjalit broadband për telefoninë e lëvizshme apo nëpërmjet zotërimit të spektrit të frekuencave. Këto teknologji kërkojnë krijimin e rrjetit të transmetimit dhe investime në pajisje teknike dhe janë të limituara. Inovacionet në teknologjinë e transmetimit gjatë viteve të fundit, i vendos operatorët e tregut në sfidën e qasjes ndaj këtyre teknologjive në funksion të të qenit konkurrues në treg.
 - **Lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera.** Operatorët në treg janë shoqëri që përfaqësojnë grupe të rëndësishme në tregjet ndërkombëtare dhe sjellin në tregun vendas misionin dhe filozofinë e grupit dhe të partnerëve të tij.
 - **Karakteristika të tjera të tregut përkatës** si: homogjenitetin e produkteve, transparencën e tregut, uniformitetin e kostos dhe të madhësisë së ndërmarrjeve, qëndrueshmërinë e kërkesës ose të kapaciteteve të lira prodhuese.
72. Mbështetur mbi gjithë elementët e nenit 8 të ligjit 9121/2003, rezulton se, si shoqëria Vodafone Albania SHA edhe bashkimi i dy shoqërive One Telecommunications SHA dhe Albtelecom SHA, janë ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e shërbimit me pakicë të telefonisë celulare, duke i dhënë tregut të shërbimit të telefonisë fikse karakteristikat e një tregu DUOPOL.
73. Duke qenë se tregu i komunikimeve elektronike është një treg që mbikëqyret nga rregullatori, në zbatim të nenit 1 dhe 34 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP duhet të realizojë analizën e tregut të shërbimit të telefonisë celulare me pakicë, me qëllim përcaktimin e Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Tregun (FNT) përkatës.

IV.2.2.2 Tregu i telefonisë fikse

74. Ofrimi i shërbimeve të telefonisë fikse realizohet nëpërmjet rrjeteve fikse (rrjeti i bakrit dhe fibra optike). Shoqëria Albtelecom zotëron rreth 80% të rrjetit të telefonisë fikse, ndërkohë që 20% e rrjetit (fibër optike) zotërohet nga shoqëria Albanian Telecommunications Union (ATU).
75. Referuar shkresës nr. 60/17 prot., i AK datë 14.02.2022 të AKEP, u konstatua se numri i sipërmarrësve që janë licencuar për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri është 46 dhe 240 sipërmarrës ofrojnë shërbime të internetit nga rrjetet fikse.
76. Nga analiza e të dhënave sasiore rezultoi se:
 - Sipas treguesit të numrit të pajtimtarëve operatori Albtelecom zotëron mbi 70% të tregut dhe me trend në rritje, i ndjekur nga ASC (Tring) me mbi 10% të tregut. Operatori One Telecommunication rezulton te ketë lidhur kontrata gjatë vitit 2021, por pjesë e tij e tregut është shumë e ulët.
 - Tregu i shërbimit të telefonisë fikse ka karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar për shkak të pjesës së madhe të tregut të operatorit Albtelekom në këtë shërbim.
77. Nëpërmjet analizës së tregut në 2013 dhe me Vendimit të KD nr. 2337, date 30.07.2013, AKEP përcaktoi që Albtelecom ka status të operatorit me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregun me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse, por bazuar në një sërë faktorësh AKEP vendosi për heqjen e detyrimit të kontrollit të tarifave me pakicë të pajtimtarëve, duke filluar nga data 1.01.2014, qëndrim i cili është duke vazhduar edhe sot.
78. Përfitimi i kontrollit të shoqërisë One Telecommunication nuk do të sjellë efekte mbi konkurrencën në tregun e shërbimit të telefonisë fikse, pasi pjesa e tregut e operatorit One është shumë e vogël, <1%, dhe delta HHI është e papërfillshme. Gjithsesi, me marrjen e kontrollit të shoqërisë Albtelecom SHA nga 4iG Nyrt, kjo e fundit, e ka të konsoliduar pjesën dominuese të tregut në shërbimin e telefonisë fikse në Shqipëri.

IV.2.2.3 Paketat e integruara

79. Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara (bundles) të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë segmenti më konkurrues midis operatorëve të rrjeteve fikse. Tendenca e operatorëve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi ditor, javor dhe mujor (30 ditor), duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS, edhe akses në Internet.
80. Nga analiza u konstatua se:
 - Tregu i shërbimit për paketat e integruara, ka karakteristikat e një tregu të përqendruar, por në një nivel shumë më të moderuar se tregjet e shërbimit të telefonisë fikse dhe celulare.
 - Operatori me pjesën më të madhe në treg është Albtelecom, por me një trend në rënie gjatë viteve të fundit, i ndjekur nga operatori Vodafone (pas blerjes dhe përthithjes së shoqërisë ABCom në vitin 2020) dhe i treti renditet operatori ASC (Tring).
81. Përfitimi i kontrollit të shoqërisë One Telecommunication nuk do të sjellë efekte mbi konkurrencën në tregun e shërbimit nëpërmjet paketave të integruara, pasi operatorit One Telecommunication nuk ofron shërbime të kësaj natyre.
82. Në përfundim të vlerësimit të strukturës së tregjeve të shërbimeve në telefoninë fikse dhe të celulare u konstatua se:
 - Transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD dhe filialit të tij, shoqërisë One telecommunication SHA nuk do të krijojë mbivendosje tregjesh në shërbimin e telefonisë nëpërmjet rrjeteve fikse duke mos shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

- Transaksioni i synuar do të krijojë mbivendosje të pjesëve të tregut në shërbimin e telefonisë së lëvizshme (celulare), duke sjellë për pasojë mbivendosje të pjesëve të tregut mes operatorëve One telecommunication SHA dhe Albtelekom SHA.
- Pas përfundimit të kontrollit mbi shoqërinë One Telecommunication, pjesa e kombinuar e tregut e dy operatorëve të kontrolluar nga shoqëria 4iG Nyr do të jetë nga 47% deri në 55% duke krijuar pozitë dominuese në tregun e shërbimeve celulare.
- Mbështetur në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, operatorët Vodafone Albania SHA dhe bashkimi i operatorëve One Telecommunication SHA dhe Albtelecom SHA kanë pozitë dominuese në tregun e shërbimeve celulare.

83. Llogaritja e indekseve të përqendrimit të tregut pas transaksionit (HHI dhe delta HII) tregojnë që përqendrimi mund të krijojë rrezik për kufizimin e konkurrencës në treg dhe për këto arsye, është e domosdoshme vlerësimi i efekteve të mundshme antikonkurruese që do të vijnë nga transaksioni i synuar.

V. Vlerësimi efekteve të mundshme antikonkurruese

84. Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” përcakton se ekzistojnë dy mënyra kryesore në të cilat përqendrimet horizontale mund të pengojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, përkatësisht, përmes efekteve të pakoordinuara dhe të koordinuara.

- Efektet e pakoordinuara vijnë si rrjedhojë e eliminimit të kufizimeve të rëndësishme të konkurrencës mbi një ose më shumë ndërmarrje, të cilat për pasojë kanë rritur fuqinë e tregut pa përdorur sjellje të koordinuar.

85. Specifikisht, për sa i përket faktit se ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim janë konkurrentë të afërt, Udhëzimi përcakton se, nëse ekziston një **shkallë e lartë e zëvendësueshmërisë** ndërmjet produkteve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim dhe të atyre të ofruara nga prodhuesit rivalë, ka pak mundësi që përqendrimi të kufizojë ndjeshëm konkurrencën efektive, në veçanti nëpërmjet krijimit ose forcimit të një pozicioni dominues.

86. Shërbimet e ofruara në tregun e telefonisë celulare janë plotësisht të zëvendësueshëm dhe miratimi nga AKEP i rregullores nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, e ndryshuar, rriti mundësinë e lëvizshmërisë së klientëve mes operatorëve. Kjo sjellje është reflektuar në rritjen e numrit të klientëve që kërkojnë portimin e numrit, të nxitur nga elementet konkurruese që përdorin shoqëritë për tërheqjen e klientëve nga konkurrentët e tjerë.

87. Nga të dhënat e administruara, konstatohet se gjatë dy viteve të fundit, është rritur në mënyrë të ndjeshme portimi i klientëve nga operatori Vodafone drejt operatorit One, fakt ky i cili shprehet në uljen e pjesës së tregut të Vodafone me 2% dhe rritjen me të njëjtën masë të operatorit One gjatë vitit 2021, ndërkohë që operatori Albtelekom ka rezultuar me ulje 1% të pjesës së tregut.

88. Përqendrimet horizontale shoqërohen **me eliminimin e një konkurrenti në treg**. Eliminimi i një force të rëndësishme të konkurrencës, bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, ka më shumë ndikim në procesin konkurrues në krahasim me pjesët e tregut që ato zotërojnë apo elementë të tjerë të ngjashëm, duke sjellë që një përqendrim ndërmjet ndërmarrjeve të tilla të ndryshojë dinamikën e konkurrencës në mënyrë të ndjeshme.

89. Për të vlerësuar këtë efekt, është analizuar **eficenca e konkurrentit që del nga tregu**, nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve të performancës financiare të tij³, nga ku rezultoi se:

³ Mbështetur në pasqyrat financiare të vitit 2018-2020 të operatorëve Vodafone Albania, One Telecommunication dhe Albtelecom

- Albtelecom rezulton me humbje për tre vitet e marra në analizë (2018-2020), humbje e cila ka ardhur duke u thelluar në vite. One Telecommunications paraqet humbje vetëm për vitin 2018, ndërsa për vitet 2019 dhe 2020 treguesit e fitimit kanë ardhur drejt përmirësimit, duke u rritur nga 3.2% në 9.7% në vitin 2020. Për Vodafone Albania konstatohet një ulje e ndjeshme e normës së fitimit në dy vitet e fundit nga 10.3% në 0.8%, e cila përben vlerën më të ulët për tre vitet e marra në shqyrtim.
 - Treguesit ROA dhe ROE për ndërmarrje Albtelecom paraqiten me vlera negative për vitet 2018-2020, duke u shoqëruar me një tregues në rënie në vlerën absolute të aseteve dhe të kapitalit të shoqërisë.
 - One Telecommunications ka përmirësuar treguesit ROA duke e rritur nga 1.6 në 4.6 në vitin 2020, e shoqëruar me një rritje rreth 8% në terma absolutë të vlerës së aseteve. Rritja e vlerës së aseteve është shoqëruar më rritjen e vlerës së kapitalit të shoqërisë duke përmirësuar treguesit e Kthimit të Kapitalit (ROE) nga 2.6 në 7.9.
 - Vodafone Albania, paraqet tregues pozitiv të indikatorëve të performancës, por me trend në rënie dhe ku indekset kapin vlerën më të ulët në vitin 2020, ROA zbrit nga 5.1 dhe 5.9 në vlerën 0.3 dhe treguesi ROE zbrit nga 6.2 dhe 7.5 në 0.5.
90. Nga sa më lartë, shoqëria Albtelecom SHA nuk është një konkurrent eficient sipas treguesve ekonomik, ndërkohë që One Telecommunication është një konkurrent me mundësi investimi dhe zhvillimi.
91. Në nenin 13, paragrafi 3, i ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, parashikohet se Komisioni, në raste të veçanta, mund të mos ndalojë përqendrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë e nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqendrimit nëse: (a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa këtë përqendrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt; (b) nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje, dhe analiza e mësipërme eidenton se ndërmarrja Albtelecom SHA është në vështirësi për të ndjekur zhvillimet teknologjike që kërkon tregu i komunikimeve elektronike.
92. Për këto arsye, gjykohet se transaksioni mund të mos ketë efekte antikonkurruese të pakoordinuara në tregun e ofrimit me pakicë të shërbimeve celulare.
- **Efektet e koordinuara** vijnë si pasojë e ndryshimit të natyrës së konkurrencës në një mënyrë të tillë, që ndërmarrjet që më parë nuk kishin koordinuar sjelljet e tyre, kanë më shumë mundësi që në mënyrë të dallueshme të koordinojnë dhe të ngrenë çmimet apo të dëmtojnë konkurrencën efektive. Gjithashtu, një përqendrim e bën koordinimin më të lehtë, më të qëndrueshëm ose më efektiv për ndërmarrje të cilat koordinonin sjelljen e tyre para përqendrimit.
93. Lidhur me efektet e koordinuara të përqendrimit, duhet të vlerësohet nëse është e mundur të ketë një koordinim të sjelljes mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse, dhe nëse ky koordinim është i qëndrueshëm. Që koordinimi të jetë i qëndrueshëm duhet të plotësohen tre kushte:
- (i) ndërmarrjet koordinuese kanë mundësi për të monitoruar në një shkallë të ndjeshme, nëse ruhen termat e koordinimit;
 - (ii) ekzistenca e disa formave të mekanizmave mbështetës, të besueshëm që mund të veprojnë në qoftë se zbulohet devijimi;
 - (iii) kundërveprimi i personave të tretë të tillë si: konkurrentët aktualë apo të ardhshëm, që nuk janë pjesë e koordinimit, ashtu edhe klientëve që nuk rrezikojnë nga rezultatet e supozuara nga koordinimi.

94. Referuar edhe rasteve të ngjashme në Evropë, efektet e përqendrimeve në telekomunikacion janë bërë objekt vlerësimi nga BEREC⁴, Body of European Regulators for Electronic Communications në BE dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, pas procedurave të përqendrimeve.⁵
95. Vlerësimi i efekteve që do të sjellë përfundimi i kontrollit të shoqërisë One Telecommunications SHA dhe Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyrtdo të bëhet ex-post, gjatë periudhës së monitorimit të sjelljes së ndërmarrjeve të prekura nga ky transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 61, pika 1, shkronja d, dh, e, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përfundimi i kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag me kushtet dhe detyrimet e mëposhtme:
 1. Detyrimin e shoqërisë 4iG Nyrtd, të mbajë të ndara llogaritë ekonomike për:
 - a. shërbimin e telefonisë fikse
 - b. shërbimin e telefonisë celulareKy detyrim të realizohet brenda 12 muajve nga data e marrjes së këtij vendimi.
 2. Detyrimin e shoqërisë 4iG Nyrtd, të mos krijojë pengesa të paligjshme për hyrjen e operatorëve të rinj në treg (MNVO).
 3. Detyrimin e shoqërisë 4iG Nyrtd të mos abuzojë me pozitën dominuese nëpërmjet:
 - a. Vendosi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të tregtimit dhe detyrimin e orientimit të tyre drejt kostos së shërbimeve.
 - b. Vendosi së palëve në kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta e të pafavorshme për konkurrencën.
 - c. Vendosi e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, ku këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

⁴ BEREC Report on Post-Merger Market Developments - Price Effects of Mobile Mergers in Austria, Ireland and Germany, qershor 2018

⁵ **Rasti nr. COMP/M.3916 –T-Mobile Austria/Tele.ring/2006**

Përqendrimi ndërmjet T-Mobile dhe Tele.ring u autorizua nga Komisioni, me kushte dhe detyrime, pas procedurave të hetimit të thelluar ku Komisioni e konsideroi Tele.ring si një forcë e rëndësishme konkurruese në tregun austriak të telefonisë celulare, pavarësisht pjesës së tij të tregut. Si pasojë e përqendrimit, numri i operatorëve në treg u reduktua nga pesë në katër. Për të eliminuar efektet antikonkurruese, T-Mobile paraqiti angazhimet si në vijim:

- Shpërndarja e dy paketave të frekuencave UMTS, njëra për H3G dhe tjetra për një konkurrent me një pjesë më të vogël tregu;
- Shpërndarja e një numri shumë të madh të siteve të telefonisë celulare që operohen aktualisht nga Tele.ring (duke përfshirë të gjitha pajisjet e nevojshme teknike), për H3G, dhe nëse është i interesuar për ONE.

Rasti Hutchinson 3G UK/ Telefónica UK/2020

Në maj 2016, Komisioni Evropian refuzoi përqendrimin ndërmjet Hutchison 3G dhe Telefónica UK, nisur nga shqetësimet se transaksioni do të zvogëlonte mundësinë e zgjedhjes për konsumatorët dhe do të sillte çmime më të larta. Komisioni vlerësoi gjithashtu se transaksioni do të dëmtonte inovacionin në sektorin e shërbimeve të telefonisë celulare. Si pasojë e përqendrimit, numri i operatorëve në treg do të reduktohej nga katër në tre.

Në maj 2020, Gjykata e Përgjithshme Evropiane dha një vendim historik, duke mbështetur apelimin e paraqitur nga CK Hutchison Holdings kundër ndalimit të Komisionit Evropian të përqendrimit të propozuar.

4. Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë vendimin nëse shoqëria 4iG Nyrt nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga AK.

II. T'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare sa më poshtë:

1. Të realizojë analizën e tregut me pakicë të shërbimit të telefonisë fikse dhe celulare, duke shpallur operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), si dhe duke përcaktuar masa rregulluese/detyrime sipas përcaktimeve ligjore.
2. Të hartojë një rregullore ku të përcaktohen procedurat për licencimin e operatorëve të rinj, Operatorë të Rrjetit Virtual Celulare.
3. Të vendosë rregulla dhe detyrime për operatorët ekzistues në tregun e telefonisë fikse dhe celulare, që të lejojnë akses, interkonjeksion dhe përdorim të përbashkët të faciliteteve të rrjetit për hyrjen në treg të Operatorëve të Rrjetit Virtual Celular.
4. Në kuptim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", t'i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshime në "Planin Kombëtar të Frekuencave", pas ndryshimit të strukturës së tregut të komunikimeve elektronike.

III. Monitorimin e zbatimit të këtyre detyrimeve për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 870, Datë 18.03.2022

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM - 934 SHPK, FERRA&CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, Devi 20 - GRUP SHPK, Eqerem - 934 SHPK, FERRA&CO SHPK, GLOBCOM SHPK, Kriket-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendim nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” dhe me vendimin nr. 815, datë 02.09.2021 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg, për periudhën kohore 1 tetor 2020 deri në 20 maj 2021.
2. Gjatë kësaj periudhe hetimore, 8 mujore u përcaktua se: treg përkatës i produktit përfshin: (i) Tregun e Importit të Vajit Vegjetal; (ii) Tregun e Prodhimit/Ambalazhimit të Vajit Vegjetal; (iii) Tregun e Shitjes me Shumicë të Vajit Vegjetal. Tregu përkatës i produktit është vaji i lulediellit. Tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
3. Nga analiza e strukturës së tregut, vlerësohet se 4 ndërmarrjet me pjesën më të madhe në tregun e importit të vajit vegjetal për vitin 2020 janë përkatësisht ndërmarrjet: Globcom SHPK me 26% të tregut, Devi-20 me 22% të tregut, Ferra&Co me 19% të tregut dhe Kriket-1 me 10% të tregut, kurse ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë më të vogël që varion nga 0%-3%, të cilat përbëjnë në total 13% të pjesëve të tregut. Konstatohet se për vitin 2020 tregu i importit të vajit vegjetal është një treg mesatarisht i përqendruar (katër ndërmarrje të mëdha).
4. Ndërmarrjet më të mëdha të cilat importojnë vaj të hapur të rafinuar janë: ndërmarrja Globcom SHPK e cila e shet me shumicë të ndërmarrjet PDF SHPK dhe Bomira SHPK; ndërmarrja Kriket-1 përsëri një pjesë

e shet me shumicë si vaj të hapur dhe një pjesë e ambalazhon për ta shitur me shumicë; ndërmarrja Bomira një pjesë të vajit të hapur të importuar e shet me shumicë si të tillë dhe një pjesë e ambalazhon për ta shitur me shumicë nën markën Bomira; ndërmarrja Ferra&Co e cila një pjesë e shet me shumicë vaj të hapur dhe një pjesë e importon me shishe; etj. Ndërmarrjet të cilat importojnë vaj të ambalazhuar të gatshëm për shitje janë: ndërmarrja Devi 20 - Grup e cila importon vajin e markës Floriol; ndërmarrja Eqerem - 934 importon vajin e markës Zollota; ndërmarrja Ferra&Co importon vajin e markës King etj.

5. Nga analiza e strukturës së tregut, vlerësohet se ndërmarrja që ka pjesën më të madhe të tregut të prodhimit/ambalazhimit për periudhën 1 tetor 2020 - 20 maj 2021 është ndërmarrja PDF SHPK me 38% të tregut. Bomira zotëron 33% të tregut të vajit vegjetal dhe më pas Kriket-1 me 21% të tregut. Të gjitha ndërmarrjet e tjera zotërojnë 3% ose më pak duke patur një total prej 8% të gjitha së bashku. Treguesit e përqendrimit tregojnë për një treg shumë të përqendruar, gjë e cila konstatohet edhe nga fakti se në tregun e prodhimit/ambalazhimit të vajit vegjetal operojnë vetëm 10 ndërmarrje.
6. Tregu i shitjes me shumicë për periudhën 1 tetor 2020 - 20 maj 2021 rezulton se, është një treg mesatarisht i përqendruar me një HHI në vlerën 1506, ku PDF ka 24%, Devi – 20 GRUP ka 18%, GLOBCOM ka 18%, Bomira ka 11%, Ferra&Co ka 9%, Kriket-1 ka 6%, Eqerem-934 ka 6% dhe Teuta ka 2%. Pjesët e tregut të ndërmarrjeve në tregun me shumicë janë më të vogla krahasuar me tregun e importit duke qenë se tregu me shumicë zmadhohet duke bërë pjesë edhe prodhuesit/ambalazhuesit të vajit vegjetal.
7. Duke vlerësuar pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrencën potenciale dhe kundërveprimin e fuqisë blerëse, asnjë nga ndërmarrjet për periudhën 1 tetor 2020- 20 maj 2021 nuk përmbush kriteret e nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003, dhe për pasojë nuk ka ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal për periudhën e hetimit në fjalë.
8. Në vijim të hetimit paraprak dhe shqetësimit në media, pjesëtarët e grupit të monitorimit të ngritur me urdhrin nr. 190 prot., datë 11.03.2022 dhe urdhrin nr. 190/2 prot., datë 16.03.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm, në datat 11.03.2022, 16.03.2022 dhe 17.03.2022 monitoruan tregun tregtimit të vajit vegjetal (shumicë dhe pakicë), nga ku rezultojë se:
 - Gjatë monitorimit në tregun e shumicës të vajit vegjetal pranë ndërmarrjeve Agro Blend SHPK dhe Ferra&Co SHPK është konstatuar se çmimet për produktin e vajit vegjetal kanë pasur rritje gjatë vitit 2022.
 - Gjatë monitorimit të tregut të pakicës për vajin vegjetal rezulton se për markat Gold (Teuta), Diamond (Agro Blend), King (Ferra&CO), Floriol (Devi-20 Grup) çmimi gjatë periudhës shkurt - mars ka pasur trend rritës. Konkretisht vaji Gold shitet me 329 lekë me TVSH, Diamond me 335 lekë me TVSH, King me 315 lekë me TVSH dhe Floriol me 319 lekë me TVSH.
9. Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për periudhën 1 janar 2022 – 11 mars 2022, u konstatua se:
 - Ndërmarrjet të cilat kanë pjesë më të madhe të tregut janë: Globcom me 30.18% të tregut; Devi - 20 Grup me 22.18% të tregut; Eqerem - 934 me 13.64%; Ferra&Co me 12.48%; Kriket-1 me 7.62%; AgroBlend me 5.21% dhe Teuta me 2.48% të tregut.
 - Çmimi mesatar mujor i importit në muajin janar 2022 ka qenë në vlerën 199.23 lekë/litri dhe në mars 2022 është rritur në vlerën 208.54 lekë/litri.
 - Çmimi i vajit vegjetal rezulton se është rritur gati me 7.5% nga muaji shkurt 2022.
10. Për sa më sipër, rezulton se: rritja në të njëjtën kohë për periudhën janar - mars 2022 e çmimit të shitjes së vajit vegjetal nga ndërmarrjet AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, Devi 20 - GRUP SHPK,

Eqerem - 934 SHPK, FERRA&CO SHPK, GLOBCOM SHPK, Kriket-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK, mund të bjerë në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, Devi 20 - GRUP SHPK, Eqerem - 934 SHPK, FERRA&CO SHPK, GLOBCOM SHPK, Kriket-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 20 maj 2021 deri në 18 mars 2022.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 871, Datë 25.03.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALPHA BANK ALBANIA SHA NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, 17, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” dhe Formulari i plotë i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt,

VËREN SE:

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi lidhur me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitje dhe blerje të aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: OTP Bank Nyrt, është një shoqëri aksionare publike. Objektivi themelor i shoqërisë është: Të operojë si një institucion financiar i regjistruar në Hungari, duke vepruar si një institucion krediti (banke), i autorizuar të ofrojë gamën e plotë të shërbimeve bankare dhe investimeve dhe me aktivitet kryesor të shoqërisë ndërmjetësime të tjera monetare etj.

OTP Bank Nyrt, është aktive në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të saj Banka OTP Albania SHA, shoqëri me objekt aktiviteti: a) pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë, inter alia, kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj.

Pala shitëse: Alpha International Holdings Single Member S.A, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, me objekt veprimtarie: Krijimin ose pjesëmarrjen në subjekte të sektorit financiar, vendas ose të huaj, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Shoqëria Alpha International Holdings Single Member S.A. vepron në Shqipëri nëpërmjet filialit të saj Alpha Bank Albania SHA.

Shoqëria Target: Alpha Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Kryerja e aktiviteteve bankare dhe financiare, në përputhje me ligjin ekzistues për bankat apo sipas ndryshimeve që mund të ketë në të ardhmen, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, etj.

Njoftimi i përqendrimit është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda afatit 30 ditor, duke plotësuar kriteret e nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në zbatim të nenit 13 të rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, është bërë njoftimi në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës dhe janë ftuar palët e interesuara të shprehin opinionin e tyre mbi transaksionin e njoftuar. Pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk është paraqitur asnjë opinion nga palë të interesuara.

II. Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë Alpha International Holdings Single Member S.A (shitësi) dhe shoqërisë OTP Bank Nyrt (blerësi), është lidhur “Marrëveshje për shitje dhe blerje të aksioneve”, datë 06 dhjetor 2021, nëpërmjet të cilës shitësi ka rënë dakord të shesë të gjithë kapitalin e regjistruar të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA, dhe blerësi ka rënë dakord të blejë Kuotat, sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje.

Përfundimi i transaksionit do të kushtëzohet me plotësimin e kushteve, duke marrë pëlqimin paraprak të Bankës së Shqipërisë; Autoritetit të Konkurrencës të Shqipërisë; Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të Serbisë; Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës të Malit të Zi dhe Bankës Kombëtare të Hungarisë.

Në zbatim të detyrimit kontraktore, përfaqësuesi ligjor i OTP Bank Nyrt në Shqipëri i është drejtuar Bankës së Shqipërisë, për miratimin e ndryshimit të kontrollit, e cila nëpërmjet shkresës nr. 18/2 prot. i BSH, datë 03.02.2022 “Mbi plotësimin e dokumentacionit që shoqëron kërkesën për zotërimin e kontrollit të Alpha Bank Albania SHA nga aksionari i ri OTP Bank Plc., Hungari”, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit për vlerësimin e transaksionit të njoftuar dhe ndërkohë Banka e Shqipërisë do të jetë në pritje të vlerësimit nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Banka Qendrore e Hungarisë.

Jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data e përfundimit të marrëveshjes, blerësi do të sigurohet të ndryshojë emrin ligjor të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA në një emër të ri që nuk përfshin fjalët “Alpha Bank”; do të pushojë së përdoruri ose shfaquri Alpha Bank në çfarëdo mënyre që të jetë e dukshme për çdo palë të tretë dhe jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas datës së përfundimit, të zëvendësojë të gjitha kartat e kreditit dhe kartat e debitit të emërtuara nga Alpha Bank Albania SHA.

Referuar marrëveshjes dhe pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të plotë të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt, i parashikuar në nenin 10, 12 dhe 17 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Duke qenë se shoqëria OTP Bank Nyrt zotëron në Shqipëri bankën OTP Albania SHA, transaksioni i njoftuar do të ketë për pasojë përfitim të kontrollit të një konkurenti të afërt në tregun e shërbimeve bankare, duke u klasifikuar si një përqendrim horizontal.

III. Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit, prekur nga transaksioni, do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare. Për analizimin e këtij rasti, *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

11. Përcaktimi i strukturës së tregut

Tregu i shërbimeve bankare mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997

"Për Bankën e Shqipërisë"; ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve të tjera rregullatore të nxjerra në zbatim të ligjeve.

Në fund të vitit 2021, në sistemin bankar operonin 12 banka të nivelit të dytë, nga të cilat 4 banka janë me kapital shqiptar dhe 8 me kapital të huaj.

Mbështetur në përcaktimin e tregut përkatës të produktit si dhe Udhëzimin "Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale", miratuar më vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 131 datë 07.12.2009, vlerësimi i efekteve të një përqendrimi në konkurrencën në treg fillon me analizën e strukturës së tregut përkatës të produktit, analizë kjo e fokusuar në treguesit kryesorë të sistemit bankar që janë aktivet, depozitat dhe kreditë. Indeksi Herfindahl- Hirschman (HHI) tregon nivelin e përqendrimit të këtyre tregjeve.

Analiza e strukturës së tregut sipas treguesve kryesor të sistemit bankar është mbështetur në të dhënat e publikuara nga Shoqata Shqiptare e Bankave për vitin 2020, në të cilën bankat me pjesën më të madhe në treg janë: BKT, Banka Credins, Banka Raiffeisen dhe Banka Intesa Sanpaolo.

- Në terma të aktiveve/aseteve, tregu bankar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar ku indeksi i Herfindahl- Hirschman (HHI) është në vlerën XX.

Sipas këtij treguesi, kryeson Banka Kombëtare Tregtare me XX%, e ndjekur nga Credins Bank me XX%, Raiffeisen Bank me XX% dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania me XX%. Sipas këtyre të dhënave, OTP Bank Albania zë rreth XX% të tregut të aktiveve dhe Alpha Bank Albania XX% të këtij tregu.

Transaksioni do të sjellë mbivendosje të pjesëve të tregut të OTP Bank Albania SHA dhe Alpha Bank Albania SHA dhe pjesa e kombinuar në terma të aktiveve e OTP Bank Albania SHA dhe Alpha Bank Albania SHA do të shkojë në XX% (duke u renditur e 5-ta) dhe $\Delta HHI = XX$

- Në terma të depozitave, tregu klasifikohet si mesatarisht i përqendruar ku indeksi i Herfindahl- Hirschman (HHI) është në vlerën XX.

Banka Kombëtare Tregtare renditet e para me XX% e ndjekur nga Credins Bank me XX%, Raiffeisen Bank me XX% dhe Intesa Sanpaolo Bank me XX%. Sipas të dhënave, OTP Bank zë rreth XX% të tregut të depozitave dhe Alpha Bank Albania XX%. Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut, në terma të depozitave e OTP Bank Albania SHA dhe Alpha Bank Albania SHA, do të shkojë në XX% dhe $\Delta HHI = XX$

- Në terma të kredive, tregu bankar klasifikohet si mesatarisht i përqendruar ku indeksi i Herfindahl- Hirschman (HHI) është në vlerën XX.

Në këtë segment tregu, kryeson Credins Bank me XX% e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare me XX% dhe Raiffeisen Bank me XX% . OTP Bank Albania SHA mbulon rreth XX% të këtij tregu dhe Alpha Bank SHA XX%. Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar, në terma të kredive, do të shkojë në XX% (duke e renditur OTP Bank në vendin e 3-të) dhe $\Delta HHI = XX$

12. Vlerësimi i efekteve mbi konkurrencën.

Referuar Udhëzimit "Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale" dhe analizës SIEC (Significant Impediment to Effective Competition), një përqendrim horizontal mund të ndikojnë në konkurrencën në treg nëpërmjet kufizimeve të cilat mund të vijnë si pasojë e forcimit të pozitës së ndërmarrjeve në përqendrim. Vlerësimi i strukturave të tregjeve është indikator bazë i vlerësimit të fuqisë së një ndërmarrjeje në treg, e cila i jep ndërmarrjes mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke e bërë atë të aftë të veprojë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg.

Sipas këtij Udhëzimi, Autoriteti mund të mos identifikojë probleme që lidhen me konkurrencën kur indeksi HHI pas përqendrimit varion nga 1000 në 2000 dhe ndryshimi i indeksit është nën 250. Sipas analizës së strukturës së tregut u konstatua se tregu i shërbimeve bankare në terma të aktiveve, kredive dhe depozitave

paraqitet mesatarisht i përqendruar, ku treguesi i përqendrimit të tregut (HHI) varion mes 1000 dhe 2000. Dy ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim nuk zotërojnë pjesë të mëdha tregu dhe ndryshimi i indeksit të përqendrimit ΔHHI është më e vogël se XX, duke e bërë të pamundur që sjellja OTP Bank Albania të jetë dominuese apo detyruese për konkurrentët e tjerë.

Përqendrimet horizontale shoqërohen me eliminimin e një konkurenti në treg. Eliminimi i një force të rëndësishme të konkurrencës, bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, ka më shumë ndikim në procesin konkurrues në krahasim me pjesët e tregut që ato zotërojnë apo elementë të tjerë të ngjashëm, duke sjellë që një përqendrim ndërmjet ndërmarrjeve të tilla të ndryshojë dinamikën e konkurrencës në mënyrë të ndjeshme.

Për të vlerësuar këtë efekt, është analizuar efica e konkurrentit që del nga tregu, nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve të performancës financiare të tij sipas termave ekonomikë, rezultatit financiar, normë së kthimit të investimeve (ROE) dhe normës së kthimit të aseteve (ROA).

Sipas këtyre indekseve, si dhe mbështetur në modelin e vlerësimit dhe projeksionit të situatës financiare të OTP Bank SHA pas përqendrimit, rezulton se OTP Bank Albania SHA ka tregues më të mire financiar se Alpha Bank Albania SHA, gjë e cila tregon se konkurrenti që do të mbetet në treg është më efektiv.

Tregu i shërbimeve bankare ka qenë herë pas here objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës, ku Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet rekomandimeve për bankat e nivelit të dytë, ka kërkuar prej tyre rritjen e konkurrencës nëpërmjet uljes së kostove bllokuese të lëvizshmërisë së klientëve nga një bankë në tjetrën, rritjen e transparencës së informacionit ndaj klientëve (duke i bërë më të kuptueshme termat e shërbimeve si dhe kostot për klientin) si dhe zgjerimin e gamës së produkteve nëpërmjet platformave elektronike me qëllimin e reduktimit të kostove administrative.

Mbështetur në vlerësimin e elementëve të mësipërm gjykojmë se, përqendrimi i synuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyr.
2. Monitorimin e sjelljes së shoqërisë OTP Bank Albania SHA, për një periudhë 1 vjeçare nga data e marrjes së këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 872, Datë 25.03.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT NGA SIEMENS ENERGY AG, NËPËRMJET FILIALIT TË ZOTËRUAR PLOTËSISHT, SIEMENS GAS AND POWER HOLDING B.V., MBI BIZNESIN GREK TË ENERGJISË”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Siemens Energy AG, nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht, Siemens Gas And Power Holding B.V., mbi Biznesin Grek të Energjisë.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Siemens Energy AG, nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht, Siemens Gas And Power Holding B.V., mbi Biznesin Grek të Energjisë,

VËREN SE:

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Biznesit Grek të Energjisë nga shoqëria Siemens Gas and Power Holding B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje ndryshuese mbi Marrëveshjen Kuadër” të datës 30 mars 2020, e nënshkruar në datë 24 dhjetor 2021, palët në marrëveshje janë:

Siemens Aktiengesellschaft (Siemens AG), është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, me fushë aktiviteti; fokusimi në fushat e elektrifikimit, automatizimit dhe dixhitalizimit, të elektronikës dhe inxhinierisë industriale në botë. Konglomerati gjerman prodhon gjithçka, nga kujdesi shëndetësor dhe teknologjitë e ndërtimit të automatizimi i fabrikave dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë dhe bizneset e kujdesit shëndetësor. Siemens AG është një korporatë konglomerate shumëkombëshe gjermane dhe kompania më e madhe prodhuese industriale në Evropë.

Siemens Energy AG, është një shoqëri aksionare e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt veprimtarie; Prodhimi, furnizimi, administrimi dhe shpërndarja, si dhe tregtia e produkteve, sistemeve, pajisjeve dhe zgjidhjeve, dhe ofrimi i mirëmbajtjes, riparimit dhe shërbimeve të tjerasi dhe kërkimi

dhe zhvillimi në fushat e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe magazinimit, në fushën e naftës dhe të gazit përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës në fushat e dekarbonizimit, etj.

Siemens Energy Global GmbH & Co.KG, është një shoqëri komandite e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë, e cila zotërohet 100% nga Siemens Energy AG, ndërmjet ortakut të përgjithshëm, shoqërinë Siemens Energy Management GmbH, e cila nuk ka të drejtë dhe as nuk detyrohet të japë një kontribut kapital dhe nuk merr pjesë në kapitalin dhe aktivet e shoqërisë. Objekti i aktiviteti të shoqërisë; prodhimin, furnizimin, operimin, shitjen dhe tregtinë me produkte, instalime, zgjidhje dhe ofrim të mirëmbajtjes, riparime dhe shërbime të tjera si dhe kërkimi dhe zhvillimi në fushat e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe magazinimit të energjisë, zonat e naftës dhe gazit, etj.

Sipas marrëveshjes spin-off të datës 22.05.2020; vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 22.05.2020 dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë transferuese datë 09.07.2020, shoqëria Siemens Energy AG ka marrë pjesë të aseteve nga Siemens AG, në përputhje me dispozitat e detajuara të Marrëveshjes spin-off dhe transferimit.

Siemens Gas and Power Holding B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: themelimin, pjesëmarrjen dhe financimin në shoqëri dhe biznese, etj.

Siemens Energy S.A është një shoqëri anonime e themeluar sipas legjislacionit grek. Në transaksionet ndërkombëtare të shoqërisë, emërtimi i shoqërisë do të jetë Siemens Energy Single Member Societe Anonyme dhe me titullin dallues Siemens Energy S.A. Qëllimi i shoqërisë është: kërkimi dhe zhvillimi, mekanika, ndërtimi, shitja, shpërndarja dhe shfrytëzimi i produkteve, sistemeve, faciliteteve dhe zgjidhjeve në sektorët e prodhimit të energjisë, të shpërndarjes së energjisë, të depozitimit të energjisë, të nxjerrjes, të shfrytëzimit dhe të përpunimit të naftës dhe të gazit ajror, etj.

Biznesin Grek i Energjisë do të ndahet nga Siemens A.E dhe do të përbëhet nga shoqëria Siemens Energy S.A, e cila është themeluar për këtë qëllim.

Shoqëria Siemens A.E zotëron një degë në Shqipëri nëpërmjet **Siemens A.E Electrotechnical Projects and Products** – Dega në Shqipëri, është një shoqëri me formë ligjore, Degë e shoqërisë së huaj, me fushë veprimtarie; Marrja e masave të sigurisë elektronike, automatizimi industrial për industrinë e naftës dhe ndërtimet elektromekanike.

II. Përqendrimi

Më datë 24 dhjetor 2021, është nënshkruar në mënyrë elektronike, ndërmjet shoqërisë Siemens A.E Electrotechnical Projects and Products, Siemens Aktiengesellschaft dhe Siemens Energy Global GmbH & Co.KG, “Marrëveshje ndryshuese për Marrëveshjen Kuadër”, datë 30 mars 2020. Referuar pjesës hyrëse të kësaj Marrëveshje, citohet se: Siemens Gas and Power Holding BV, filial i zotëruar plotësisht nga Siemens Energy, ka themeluar një filial në pronësi të plotë të quajtur Siemens Energy AE (SE NewCo). Palët, pjesë e kësaj Marrëveshje, synojnë të ndërpresin dhe ta transferojnë biznesin energjetik tek shoqëria SE NewCo dhe të zgjidhin “Marrëveshjen Kuadër”.

Biznesi i energjisë, i shoqërisë Siemens A.E Electrotechnical Projects and Products do të transferohet tek SE NewCo me anë të ndarjes kundrejt zmadhimit të kapitalit aksionar të SE NewCo nga 25.000 euro në 2.000.000 euro, me emetimin e 197.490 aksioneve të reja në shuma nominale prej 10 euro secila (aksionet e reja) për Siemens dhe Siemens International Holding BV (ndarja e energjisë). Për të zbatuar këtë ndarje të Biznesit Energjetik, palët e mësipërme *do të lidhin*; Marrëveshjen e Ndarjes dhe Marrëveshjen Ndhimëse të Ndarjes. Siemens, Siemens International Holding BV dhe SGP Holding do të lidhin dhe një “Marrëveshje Shitje dhe Transferimi të Aksioneve”.

Referuar Raportit të Përbashkët të Ndarjes, pika 3 e Marrëveshjes së Dekonsolidimit (shtojca 19 e Marrëveshjes së Ndarjes dhe transferimit) të Bordit të Drejtorëve të Siemens AG dhe Siemens Energy AG, për ndarjen e pjesëmarrjes së shumicës në Siemens Gas and Power GmbH & Co.KG dhe të partnerët kryesorë duke përfshirë Siemens Energy Business, sqarohet se; *Biznesi i Siemens Energy do të administrohet nga Siemens Energy AG në mënyrë autonome dhe të pavarur nga Siemens AG. Siemens AG nuk synon të ushtrojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi kontroll influencues tek Siemens Energy AG. Pas hyrjes në fuqi të ndarjes, biznesi i Siemens Energy nuk do të konsolidohet më plotësisht në pasqyrat financiare të konsoliduara të Siemens AG.*

Marrëveshja e Dekonsolidimit parashikon i) kufizim të drejtën e votës, për vendimet që ndikojnë në përbërjen e bordit mbikëqyrës, nga Siemens AG dhe Siemens Beteiligungen Inland (SBI GmbH) në asamblatë e aksionarëve të Siemens Energy AG; ii) shumica e përfaqësuesve së aksionarëve në bordin mbikëqyrës të Siemens Energy AG do të jenë të pavarur nga Siemens AG në të ardhmen; iii) një anëtar i bordit mbikëqyrës (i ashtuquajtur i anëtar i veçantë i bordit mbikëqyrës), i cili duhet të jetë i pavarur nga Siemens AG dhe SBI GmbH, do të ushtrojë më tej vetëm një numër të reduktuar të votave të tyre për emërim dhe shkarkim.

Gjithashtu Marrëveshja e Dekonsolidimit do të rregullojë transferimin e aksioneve në Siemens Energy AG, brenda grupit të ardhshëm të Siemens, zbatimin e detyrimeve nga aksionaret e tjerë të Siemens Energy AG, dispozitat përmbyllëse, veçanërisht për afatin, mënyrat e zgjidhjes së marrëveshjes dhe dispozitat standarde përfundimtare.

Transaksioni i propozuar do të sjellë përfitim të kontrollit të vetëm nga Siemens Energy AG, nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht, Siemens Gas and Power Holding B.V., mbi Biznesin Grek të Energjisë, i cili është përthithur nga Siemens Energy S.A.

Për sa më sipër, kjo do të sjellë ndryshim kontrolli, pasi Siemens AG nuk do ushtrojë kontroll mbi Siemens Energy Group pas ndarjes (spin-off).

Referuar marrëveshjeve si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përben një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës mund të konsiderohet tregu i Sistemeve të Zbatimeve Industriale në segmentin e Gazit dhe Energjisë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim kontrolli i Biznesit Grek të Energjisë nga shoqëria shoqëria Siemens Gas and Power Holding B.V.

Siemens Energy AG nuk ka prezencë të përhershme në Shqipëri për momentin. Siemens A.E. i cili ka një degë të regjistruar në Shqipëri, vepron momentalisht si agent/distributor i Siemens Energy Group sipas Marrëveshjes së Agjencisë dhe Shpërndarjes dhe realizon xhiro në tregun shqiptar në segmentin e Gazit dhe Energjisë nëpërmjet një klienti të vetëm, projekti TAP.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga Siemens Energy AG, nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht, Siemens Gas And Power Holding B.V., mbi Biznesin Grek të Energjisë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 873, Datë 25.03.2022

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË A4nXT
GMBH DHE LUFTHANSA INDUSTRY SOLUTIONS AS GMBH”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH,

VËREN SE:

I. Palët në transaksioni dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, palët janë:

Pala 1: A4nXT GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: blerjen, mbajtjen, administrimin dhe shitjen e investimeve kryesisht në shoqëri vendase ose shoqëri të të gjitha llojeve, si dhe mbështetjen dhe këshillimin, duke përfshirë marrjen përsipër të shërbimeve për këto shoqëri dhe AUDI AG.

A4nXT GmbH është një filial i zotëruar plotësisht nga AUDI Aktiengesellschaft, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman dhe një filial i zotëruar plotësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Pala 2: Lufthansa Industry Solutions AS GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve IT, veçanërisht zhvillimi i softuerëve, si dhe i shërbime konsultimi, shërbimet e infrastrukturës dhe shërbimet e komunikimit.

Lufthansa Industry Solutions AS GmbH është një filial i zotëruar plotësisht nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit Lufthansa. Grupi Lufthansa është prezent në tregun shqiptar nëpërmjet: Degës në Shqipëri Deutsche Lufthansa; Lufthansa Industry Solutions SHPK; Degës në Shqipëri Austrian Airlines dhe Degës në Shqipëri Austrian Airlines AG, të cilat operojnë në tregun e shitjes së biletave të fluturimit si dhe aktivitete të lidhura me prodhimin dhe zhvillimin e software-ve.

Ndërmarrja e përbashkët (JV) do të themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit gjerman, me selinë e saj në Mynih, Gjermani. JV do të ofrojë shërbime konsulence IT dhe shërbime ndihmëse IT për palët e treta.

JV aktualisht nuk ka plane që të jetë aktive në Shqipëri në të ardhmen e afërt.

Në zbatim të nenit 13 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” është bërë njoftimi në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës dhe janë ftuar palët e interesuara të shprehin opinionin e tyre mbi transaksionin e njoftuar. Pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk është paraqitur asnjë opinion nga palët e interesuara.

II. Transaksioni

Më datë [] është nënshkruar “Marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët” ndërmjet shoqërive A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Sikurse është përcaktuar në marrëveshjeje, [].

Mbështetur në [].

Sapo shoqëria [].

Në përgjigje të [].

Palët kanë rënë dakord [].

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 3.2 “E drejta e vetos”, parashikohet se kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësim në organet vendimmarrëse. Në këtë rast aksionarët kanë të drejta vetoje, të cilat i japin kontroll të përbashkët dhe përfshijnë zakonisht vendime mbi çështje të tilla si: buxheti, plani i biznesit, investime të mëdha ose caktimi i menaxherëve kryesorë. Gjithashtu edhe vetëm një e drejtë vetoje mbi planin e biznesit mund të jetë e mjaftueshme për të dhënë kontroll të përbashkët edhe në mungesë të ndonjë vetoje tjetër.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një shoqërie të përbashkët (joint venture) me funksione të plota nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve të konsulencës dhe shërbimeve ndihmëse IT për palët e treta, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

A4nXT GmbH është një shoqëri holding dhe një filial i zotëruar indirekt nga grupi Volkswagen AG, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK me aktivitetet përkatësisht në tregun e shitjes së automjeteve dhe qerasë financiare e sigurimeve.

Lufthansa Industry Solutions AS GmbH është filial i zotëruar plotësisht nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit Lufthansa, e cila është prezente në Shqipëri nëpërmjet shoqërive: Deutsche Lufthansa – Dega Shqipëri; Austrian Airlines - Dega Shqipëri; Austrian Airlines AG - Dega Shqipëri dhe Lufthansa Industry Solutions SHPK, në tregun e shitjes së biletave të fluturimit si dhe aktivitete të lidhura me prodhimin dhe zhvillimin e software-ve.

Ndërmarrja e përbashkët me funksione të plota (J-V) nuk ka plane që të jetë aktive në Shqipëri në të ardhmen e afërt.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 874, Datë 25.03.2022

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.03.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26, neni 43, pika 5, neni 74, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin e thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar; pretendimet/shpjegimet e dhëna nga ndërmarrjet AGRO BLEND SHPK, ÇAÇA SHPK, MBM SHPK dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në seancat dëgjimore të zhvilluara pranë AK-së më datë 17.03.2022 dhe 23.03.2022, si dhe të paraqitura me shkrim, në vijim të seancës dëgjimore respektivisht: AGRO BLEND SHPK me shkresën e datës 17.03.2022, protokolluar pranë AK nr. 122/10 prot., datë 17.03.2022, “Pretendime mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE, përkundrejt Agro Blend SHPK”; Materiale të depozituara nga CACA SHPK, protokolluar pranë AK me nr. 122/11 prot., datë 17.03.2022; Shkresa e MBM SHPK me nr. 169/4 prot. AK, datë 23.03.2022, “Pretendime dhe parashtrime me shkrim mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE”; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura nga ndërmarrjet: AGRO BLEND SHPK, ÇAÇA SHPK, MBM SHPK,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 783, datë 12.03.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003.
2. Për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 784, datë 12.03.2021 ka vendosur marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të

plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.

3. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimeve të mësipërme, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 138/2, datë 12.03.2021, "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e AK gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të masës së përkohshme, referuar informacionit të administruar nga inspektimet e realizuara në ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi, Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 794, datë 27.04.2021, "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK për mos zbatimin e masës së përkohshme marrë me VKK nr. 784, datë 12.03.2021, "Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore", ka vendosur gjobitjen e ndërmarrjeve për moszbatim të masës së përkohshme sipas VKK nr. 784/2021, si dhe detyrimin e tyre që të veprojnë në përputhje me këtë vendim.
5. Lidhur me vendimin nr. 794, datë 27.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës, ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe ÇAÇA SHPK, kanë paraqitur ankim pranë AK-së duke kërkuar shfuqizimin e tij. Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave, Komisioni i Konkurrencës me vendimet nr. 800, datë 21/05/2021 dhe nr. 801, datë 21/05/2021 ka vendosur rrëzimin e kërkesave të shoqërive ÇAÇA SHPK dhe AGRO BLEND SHPK për shfuqizimin e vendimit nr. 794/2021.
6. Referuar konkluzioneve të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 806, datë 04.06.2021, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK, për periudhën kohore nga 1 Janari 2020 deri 30 Shtator 2021.
7. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: ndërmarrjet që operojnë në tregun objekt hetimi; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
8. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, më datë 17.03.2022 dhe 23.03.2022, zhvilloi seanca dëgjimore me përfaqësues të ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK, si dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Prapësimet e paraqitura nga këto ndërmarrje në seancë dëgjimore, si dhe të paraqitura me shkrim prej tyre, janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në marrjen e këtij vendimi.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

9. Tregu i plehrave kimike që përdoren në bujqësi, ose Fertilizuesve, funksionon dhe rregullohet nga ligji nr. 17/2020 "Për produktet plehëruese", i cili përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit e strukturave përkatëse.

10. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
- a) Tregu përkatës i produktit;
 - b) Tregu përkatës gjeografik.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

11. **Tregu përkatës i produktit**¹ përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*.
12. Plehrat janë lëndë organike ose minerale, që përmbajnë elemente ushqyese për bimët dhe që hidhen në tokë ose në pjesën mbiotokësore të bimëve (plehrimi gjethor) për të rritur pjellorinë e tokës. Ato ndahen në organike dhe minerale (kimike).
13. Bazuar në vendimin nr. 806, datë 04.06.2021, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK”, për analizën e këtij tregu janë marrë parasysh tre produktet kryesore, të cilët përdoren në ciklin e bimës dhe janë produktet DAP, Nitrat dhe Ure.
14. *Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës* ndodh në rastet kur një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, produktet DAP, Nitrat dhe Ure kanë në përbërje të tyre elementë kimikë të ndryshëm, të cilët në varësi të llojit të tokës dhe të kulturës që do të mbidhet kanë përdorim të ndryshëm dhe nuk mund të zëvendësojnë njëri – tjetrin për nga funksioni që kryejnë. Kërkesa për produktet DAP, Nitrat dhe Ure është inelastike, për shkak të domosdoshmërisë sezonale të përdorimit të tyre në ciklin e bimës, këto produkte do vazhdojnë të kërkohen/blihen nga fermerët pavarësisht rritjes së çmimit.
15. *Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës* ndodh nëse ofruesit janë të aftë të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe ti tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto shtesë, në përgjigje të ndryshimeve të vogla ose përhershme të çmimeve. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës mund të themi se produktet DAP, Nitrat dhe Ure janë të zëvendësueshëm pasi shitësit me shumicë të këtyre produkteve mund të importojnë secilin nga këto produkte.
16. *Lidhur me barrierat e hyrjes* në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat, Ure konstatohet se nuk ekzistojnë barrierat ligjore për futjen në këtë treg të ndërmarrjeve të reja, por nga pikëpamja ekonomike, një hyrje e re në këtë treg kërkon investim financiar për të përmbushur kushtet e transportit dhe magazinimit. Kushtet në magazina duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të produkteve plehëruese, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketë, si dhe përmbushjen e kërkesave në fuqi për mbrojtjen e mjedisit nga kimikatet.
17. Duke patur parasysh se në varësi të llojit të bimës që do mbillet, llojit të tokës dhe karakteristikave të tjera, fermerit i duhet të zgjedhë një lloj plehu kimik të përshtatshëm për tokën dhe bimët që do të mbjellë duke përdorur sasinë e nevojshme të elementeve ushqyese dhe në kohën më optimale që duhet, plehrat kimike

¹ Bazuar në Udhëzimin “Për përcaktimin e Tregut Përkatës” dhe nenin 3, pika 7, të ligjit nr.9121/2003.

DAP, Nitrat dhe Ure kanë përdorim të ndryshëm dhe nuk mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin për nga funksioni që kryejnë. Për sa më sipër produktet DAP, Nitrat dhe Ure do të klasifikohen në nëntregje të veçanta.

18. Sa më sipër, për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është: *Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, i ndarë në nëntregje sipas produkteve:*

- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit DAP;*
- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Nitrat;*
- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Ure.*

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

19. Importi dhe tregtimi me shumicë i plehrave kimike realizohet nga ndërmarrje, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, *pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm.*

20. Për sa më sipër, **tregu përkatës** në këtë rast është konsideruar: *Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, në territorin e Republikës së Shqipërisë, i ndarë në nëntregje sipas produkteve:*

- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit DAP;*
- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Nitrat;*
- *Nëntregu i importit dhe shitjes me shumicë të produktit Ure.*

II.2 Analiza e strukturës së tregut të importit dhe shitjes me shumicë

21. Lidhur me volumet e importit të produktit DAP, nga të dhënat e DPD rezulton se gjatë vitit 2020 pjesën më të madhe e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK me rreth 35% pjesë tregu secili dhe IAM SHPK rreth 30%. Për periudhën Janar-Shtator 2021 kanë realizuar importe të produktit DAP në sasi më të mëdha ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK, përkatësisht me rreth 54% dhe 45% të tregut. Vihet re se gjatë periudhës janar-shtator 2021 në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjeve Agro Blend SHPK nga 34.63% në 53.48% dhe MBM SHPK nga 34.89% në 45.26%, ndërsa ndërmarrja IAM nuk ka realizuar importe të produktit DAP për periudhën janar-shtator 2021. Volumi i importit të produktit DAP nga viti 2020 në periudhën janar-shtator 2021 është rritur me rreth 3.3%.

22. Lidhur me indekset e përqendrimit CR3 dhe HHI, gjatë periudhës hetimore tregu i importit të plehut kimik DAP është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 HHI është 3,187, ndërsa për periudhën janar-shtator 2021 HHI rezulton të jetë 4,910, gjë që tregon se ka një rritje të këtij treguesi. Kjo ka ndodhur për shkak se gjatë periudhës janar - shtator 2021 produkti DAP është importuar kryesisht nga dy ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK, të cilat zënë sëbashku 98.74% të tregut të importit të produktit DAP.

23. Lidhur me volumet e importit të produktit Nitrat, nga të dhënat e DPD rezulton se gjatë vitit 2020 pjesën më të madhe të importeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK me rreth 63% pjesë tregu dhe MBM SHPK me rreth 35%. Për periudhën Janar - Shtator 2021 ka realizuar importe të produktit Nitrat në sasi më të mëdha ndërmarrja Agro Blend SHPK, përkatësisht me 91.5% të tregut. Ndërmarrja MBM SHPK e cila realizonte rreth 35% të importit gjatë vitit 2020, nuk ka importuar nitrat gjatë periudhës janar-shtator 2021. Vihet re se gjatë periudhës janar-shtator 2021 në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes Agro Blend SHPK nga 63.42% në 91.5%, ndërsa ndërmarrja MBM SHPK nuk ka

realizuar importe gjatë periudhës janar - shtator 2021. Volumi i importit të produktit Nitrat nga viti 2020 në periudhën janar - shtator 2021 është ulur me rreth 70%.

24. Lidhur me indekset e përqendrimit CR3 dhe HHI, vihet re së gjatë periudhës hetimore tregu i importit të plehut kimik Nitrat është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 HHI është 5,215, ndërsa për periudhën janar - shtator 2021 HHI rezulton të jetë 8,381, pra ka një rritje të madhe të këtij treguesi. Kjo ka ndodhur për shkak se gjatë periudhës janar - shtator 2021 produkti Nitrat është importuar kryesisht nga ndërmarrja Agro Blend SHPK, e cila zë 91.5% të tregut të importit të produktit Nitrat.
25. Lidhur me volumet e importit të produktit Ure, nga të dhënat e DPD rezulton se gjatë vitit 2020 pjesën më të madhe të importeve e kanë realizuar MBM SHPK me pjesë tregu rreth 33%, IAM SHPK me 21.45%, Agro Blend SHPK me 20.44% dhe CACA SHPK me rreth 19%. Për periudhën Janar - Shtator 2021 kanë realizuar importe të produktit Ure në sasi më të mëdha ndërmarrjet Agro Blend SHPK me pjesë të tregut rreth 58% dhe MBM SHPK me rreth 22% të tregut ndërsa ndërmarrja CACA SHPK zë një pjesë tregu prej 8.2%. Vihet re se gjatë periudhës janar-shtator 2021 në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes Agro Blend SHPK nga 20.44% në 58.27% dhe rënie të pjesëve të tregut të ndërmarrjeve MBM SHPK, IAM SHPK dhe Caca SHPK. Volumi i importit të produktit Ure nga viti 2020 në periudhën janar-shtator 2021 është ulur me rreth 12%.
26. Në lidhje me indekset e përqendrimit CR3 dhe HHI, vihet re së gjatë periudhës hetimore tregu i importit të plehut kimik Ure është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 HHI është 2,331, ndërsa për periudhën janar - shtator 2021 HHI rezulton të jetë 3,977, gjë që tregon se ka një rritje të këtij treguesi. Kjo ka ndodhur për shkak të pjesës së madhe të tregut që zë ndërmarrja Agro Blend SHPK gjatë periudhës janar - shtator 2021 (58.5 %).
27. Importi dhe shitja e plehrave DAP, Nitrat dhe Ure ka karakter sezonal, përkatësisht:
 - Importi i plehut kimik DAP realizohet kryesisht në pjesën e parë të vitit. Shitja e produktit DAP ndjek një trend sezonal, ku vërehet se pjesa më e madhe e këtij produkti shitet në fillim të vitit në periudhën Janar - Prill dhe në Shtator – Tetor.
 - Importi i plehut kimik Nitrat realizohet kryesisht në mes të vitit. Shitja e produktit Nitrat kryhet gjatë gjithë vitit, ku vërehet se pjesa më e madhe e këtij produkti është shitur midis periudhës Prill – Tetor për vitin 2020 dhe Prill – Maj për vitin 2021.
 - Importi i plehut kimik URE realizohet kryesisht gjatë gjithë vitit. Shitja e produktit Ure realizohet kryesisht në gjysmën e parë të vitit, në periudhën Janar – Qershor.
28. Për sa më sipër lidhur me volumet e importit të plehrave kimikë DAP, Nitrat dhe Ure rezulton se për vitin 2020 ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK janë ndërmarrjet me pjesë më të madhe tregu në importin e këtyre produkteve. Për periudhën janar-shtator 2021, rezulton se importet e plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure janë realizuar kryesisht nga ndërmarrja Agro Blend SHPK, e cila për këtë periudhë zë mbi 50% të tregut për secilin produkt.
29. **Duke marrë parasysh pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve, pengesat në hyrje në tregun përkatës (barrierat ekonomike), konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes dhe homogjenitetin e produkteve bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Agro Blend SHPK ka pozitë dominuese në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat, Ure.**
30. Përsa i përket strukturës së shitjes me shumicë të produkteve DAP, Nitrat dhe Ure vihet re se:

- Gjatë periudhës nën hetim, për produktin DAP tregu i shitjes me shumicë është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK me rreth 43.54% pjesë tregu, MBM SHPK me rreth 42.23% pjesë tregu dhe IAM SHPK me rreth 11.55% pjesë tregu.

Për periudhën Janar - Shtator 2021 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe IAM SHPK, përkatësisht me rreth 50.26 %, 32.83% dhe 12.06% pjesë tregu dhe ndërmarrja CACA SHPK 3% pjesë tregu.

- Gjatë periudhës nën hetim, për produktin Nitrat tregu i shitjes me shumicë është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK me 63.81% pjesë tregu, MBM SHPK me 27.59% pjesë tregu dhe CACA SHPK me 7.63% pjesë tregu.

Për periudhën Janar - Shtator 2021 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK, përkatësisht me 57.2 % dhe 39.91% pjesë të tregut.

- Gjatë periudhës nën hetim, për produktin Ure tregu i shitjes me shumicë është shumë i përqendruar. Për vitin 2020 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK me 36.75% pjesë tregu, MBM SHPK me 32.53%, IAM SHPK me 16.07% dhe CACA SHPK me 12.43 %.

Për periudhën Janar - Shtator 2021 pjesën më të madhe të shitjeve e kanë realizuar ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK, CACA SHPK përkatësisht me 45.53 % dhe 29.04%, 16.36% pjesë të tregut.

II.3 Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve

31. Gjatë hetimit të thelluar është analizuar sjellja e këtyre ndërmarrjeve në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

II.3.1 Analiza e Çmimit Mesatar të Shitjes së Produkteve Dap, Nitrat dhe Ure

32. Nga analiza e çmimit mesatar të shitjes së produkteve DAP, Nitrat dhe Ure nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK, CACA SHPK, IAM SHPK, Eco Green SHPK, Agro Mens SHPK, Agrohëlp SA SHPK, Arli International SHPK, Besniku SHPK, Lila SHPK vërehet se:

- Për produktin DAP, ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK kanë rritur njëkohësisht çmimet për periudhën Janar - Mars 2021. Për periudhën në vijim Prill - Shtator 2021 çmimet vazhdojnë të jenë të larta. Ajo që vihet re është se dy ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK kanë patur rritje të çmimit edhe në muajin gusht 2021, si dhe kanë operuar me çmime mesatare shitje të përafërta për muajt qershor dhe gusht 2021, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet.
- Për produktin Nitrat, ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK kanë rritur njëkohësisht çmimet për periudhën Janar - Mars 2021. Për periudhën në vijim, Prill - Shtator 2021 çmimet vazhdojnë të jenë të larta për Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet.
- Për produktin Ure ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK kanë rritur njëkohësisht çmimet në muajin Mars 2021. Për periudhën në vijim, Prill - Shtator 2021 çmimet kanë patur trend rritës për Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin

4, pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet.

- Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit në lidhje me sasitë e importuara dhe të shitura për produktet DAP, Nitrat, URE rezulton se ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK shesin me sasi më të mëdha se sasia e importuar ose e blerë nga ndërmarrjet brenda vendit, sjellje e cila vërehet për produktin nitrat për vitin 2020 dhe periudhën Janar-Shtator 2021, për produktin DAP për vitin 2020 dhe për produktin Ure, për vitin 2020 për ndërmarrjen Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK, ndërsa për periudhën Janar-Shtator 2021 për ndërmarrjet MBM SHPK dhe CACA SHPK. Ky fakt tregon se ndërmarrjet kanë patur sasi gjendje të produktit në fund të vitit, për pasojë çmimi i shitjes së produktit gjatë vitit duhet të reflektonte çmimet e blerjes në vitin paraardhës.
- Për sa më sipër ndërmarrjet nuk duhet të kishin rritur çmimin e shitjes së produktit në mënyrë të menjëhershme me rritjen e çmimit në bursë, por duhet të reflektonin në çmimin e shitjes, çmimin e blerjes së produktit gjendje nga viti paraardhës. Kjo tregon që ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK nëpërmjet rritjes në mënyrë të menjëhershme të çmimeve kanë koordinuar sjelljen, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.

33. Për sa më sipër vetë ndërmarrja Agro Blend SHPK në prapësimet e saj², depozituar pranë AK-së në vijim të seancës dëgjimore, deklaroi se: *“...importimi i plehrave kimike bëhet në muajin Tetor, për t'u përdorur në sezonin përkatës sipas nevojës në muajin Mars të vitit pasardhës...”*. Gjithashtu edhe ndërmarrja MBM SHPK në prapësimet e saj³, depozituar pranë AK-së në vijim të seancës dëgjimore, deklaroi se: *“Importi i plehrave kimike dhe përkatësisht produkteve DAP, Nitrat dhe Ure kryhet në periudhat shtator-tetor, në mënyrë që të përdoren në sezonin përkatës pasardhës sipas nevojave bujqësore”*. Gjithashtu në lidhje me gjendjen e inventarit të plehrave kimikë në magazinë, ndërmarrja MBM u shpreh se: *“kjo gjendje shitet me një çmim të mesatarizuar”*, gjë e cila vërteton se ndërmarrja ka pasur gjendje në magazinë. Kjo sjellje u deklarua edhe nga ndërmarrja CACA SHPK gjatë seancës dëgjimore. Këto deklarime të bëra nga vetë ndërmarrjet mbështesin konkluzionin e hetimit të thelluar se ato nuk duhet të kishin rritur çmimin e shitjes së produktit në mënyrë të menjëhershme me rritjen e çmimit në bursë, pasi kanë pasur gjendje të produkteve në magazinë nga importet e realizuara në vitin paraardhës.

34. Lidhur me formimin e çmimit për produktet DAP, Nitrat Ure, ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK gjatë seancave dëgjimore u shprehën se: *“ndërmarrjet kanë një strukturë kostojë të njëjtë ... çmimi përcaktohet nga bursa, kostot e transportit deri në magazinë, shpenzimet administrative, ambalazhimi, etj. Kësaj kostojë i shtohet edhe marzhi i fitimit dhe del çmimi i shitjes me shumicë, i cili rezulton i përafërt për ndërmarrjet e shitjes me shumicë.”* Ky argumentim i ndërmarrjeve nuk justifikon çmimet e përafërta të shitjes me shumicë.

Vlerësojmë se formimi i çmimit për secilën ndërmarrje është i ndryshëm pasi elementët që përcaktojnë çmimin përfundimtar si: kostot e përgjithshme operative të cilat nuk lidhen drejtpërdrejtë me produktin: fuqia punëtore, kapacitete magazinimi, transporti (detar ose tokësor), shpenzimet administrative; kostot direkte, si dhe fakti që produktet blihen me çmime të ndryshme në kohë të ndryshme, në sasi të ndryshme, çmimi përfundimtar i shitjes me shumicë duhet të jetë i ndryshëm dhe nuk mund të mesatarizohet pasi produkti nuk rezulton me kosto të njëjtë.

² Shkresa e Agro Blend SHPK e datës 17.03.2022, protokolluar pranë AK nr. 122/10 prot., datë 17.03.2022, “Pretendime mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE, përkundrejt Agro Blend SHPK”.

³ Shkresa e MBM SHPK me nr. 169/4 prot. AK, datë 23.03.2022, “Pretendime dhe parashtrime me shkrim mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE”.

35. Sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet reflektohet në çmime më të larta përfundimtare të shitjes, të cilat përbëjnë një sjellje të bashkërenduar në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.

II.3.2 Vlerësimi i Masës së Përkohshme

36. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 784, datë 12.03.2021, ka vendosur marrjen e masës së përkohshme. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të kësaj mase rezultoi se ndërmarrjet AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK nuk kanë zbatuar masën e përkohshme. Lidhur me këtë konstatim Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr. 794, datë 27.04.2021.
37. Lidhur me ecurinë e zbatimit të masës së përkohshme dhënë sipas VKK nr. 784/2021, si dhe në zbatim të VKK nr. 794/2021, pikat II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në analizën e të dhënave të administruara nga ndërmarrjet objekt hetimi për periudhën prill-shtator 2021, rezulton se, ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK kanë aplikuar të njëjtat çmime shitjeje për produktet DAP, Nitrat, Ure, me ato të aplikuara para dhënies së masës së përkohshme, gjë që tregon se ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK nuk kanë zbatuar masën e përkohshme sipas VKK nr. 784/2021 duke u sjellë në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003.

II.3.3 Pretendimet dhe kundërshtimet e paraqitura nga ndërmarrjet në seancën dëgjimore.

38. Ndërmarrjet Agro Blend SHPK, CACA SHPK dhe MBM SHPK gjatë seancave dëgjimore të zhvilluara me Komisionin e Konkurrencës kanë paraqitur pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure.
39. Agro Blend SHPK në prapësimet e saj⁴, depozituar pranë AK-së në vijim të seancës dëgjimore, deklaroi se: *“...importimi i plehrave bëhet në muajin Tetor, për t'u përdorur në sezonin përkatës sipas nevojës në muajin Mars të vitit pasardhës...”*. Kjo vërteton faktin që ndërmarrja ka patur sasi gjendje të produktit në fund të vitit paraardhës, për pasojë çmimi i shitjes së produktit gjatë vitit pasardhës duhet të reflektonte çmimet e blerjes në vitin paraardhës. Në këto kushte ndërmarrja nuk duhet të kishte rritur çmimin e shitjes së produktit në mënyrë të menjëhershme me rritjen e çmimit në bursë, por duhet të reflektonte në çmimin e shitjes, çmimin e blerjes së produktit gjendje nga viti paraardhës.
40. Gjithashtu edhe ndërmarrja MBM SHPK në prapësimet e saj⁵, depozituar pranë AK-së në vijim të seancës dëgjimore, deklaroi se: *“Importi i plehrave kimike dhe përkatësisht produkteve DAP, Nitrat dhe Ure kryhet në periudhat shtator-tetor, në mënyrë që të përdoren në sezonin përkatës pasardhës sipas nevojave bujqësore”*. Këto deklarime të bëra nga vetë ndërmarrjet mbështesin konkluzionin se ato nuk duhet të kishin rritur çmimin e shitjes së produktit në mënyrë të menjëhershme me rritjen e çmimit në bursë, pasi kanë pasur gjendje të produkteve në magazinë nga importet e realizuara në vitin paraardhës.
41. Ndërmarrja Çaçë SHPK nuk ka paraqitur me shkrim pretendime ndaj raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, përveç disa të dhënave ekonomike të ndërmarrjes në lidhje me produktet DAP, Nitrat dhe Ure. Gjithashtu gjatë seancës dëgjimore, ndërmarrja Çaçë SHPK nuk ka kundërshtuar gjetjet e raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure.

⁴ Shkresa e Agro Blend SHPK e datës 17.03.2022, protokolluar pranë AK nr. 122/10 prot., datë 17.03.2022, “Pretendime mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE, përkundrejt Agro Blend SHPK”.

⁵ Shkresa e MBM SHPK me nr. 169/4 prot. AK, datë 23.03.2022, “Pretendime dhe parashtrime me shkrim mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike të DAP, Nitrat dhe URE”.

42. Lidhur me formimin e çmimit për produktet DAP, Nitrat Ure, ndërmarrjet Agro Blend SHPK dhe MBM SHPK gjatë seancave dëgjimore u shprehën se: *“ndërmarrjet kanë një strukturë kostojë të njëjtë ... çmimi përcaktohet nga bursa, kostot e transportit deri në magazinë, shpenzimet administrative, ambalazhimi, etj. Kësaj kostojë i shtohet edhe marzhi i fitimit dhe del çmimi i shitjes me shumicë, i cili rezulton i përafërt për ndërmarrjet e shitjes me shumicë.”* Ky argumentim i ndërmarrjeve nuk justifikon çmimet e përafërta të shitjes me shumicë.
13. Vlerësojmë se formimi i çmimit për secilën ndërmarrje është i ndryshëm pasi elementët që përcaktojnë çmimin përfundimtar si: kostot e përgjithshme operative të cilat nuk lidhen drejtpërdrejtë me produktin: fuqia punëtore, kapacitete magazinimi, transporti (detar ose tokësor), shpenzimet administrative; kostot direkte, si dhe fakti që produktet blihen me çmime të ndryshme në kohë të ndryshme, në sasi të ndryshme, çmimi përfundimtar i shitjes me shumicë duhet të jetë i ndryshëm dhe nuk mund të mesatarizohet pasi produkti nuk rezulton me kosto të njëjtë.
43. Asnjë nga ndërmarrjet nuk ka kontestuar konkluzionet e raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, si dhe përpunimin e të dhënave në kuadër të këtij hetimi.
44. ***Për sa më sipër, referuar analizës së evidencave indirekte në lidhje me sjelljen e ndërmarrjeve siç janë: rritja e treguesve të përqendrimit, rritja e njëkohshme dhe në mënyrë të menjëhershme e çmimit të shitjes me shumicë duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet nga ndërmarrjet Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK, bie në kundërshtim me nenin 4 pika 1, gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.***

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1, gërmat a) dhe c), nenin 24, gërma d), nenin 26, nenin 43, pika 5, nenin 74, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK.
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK në shumën 118,978,015 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- III. Gjobitjen e ndërmarrjes MBM SHPK në shumën 66,088,573 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Gjobitjen e ndërmarrjes CACA SHPK në shumën 7,087,994 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- V. Monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2022**
BULETINI ZYRTAR



2022